Operatori i Sistemit të Transmetimit

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

Më dhe për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022
(me Raportin e Audituesit të Pavarur bashkëlidhur)



OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT

Përmbledhje:

Raporti i Audituesve Ligjorë ..... i-iv
Pasqyrat Financiare Te Konsoliduara 2022 1
Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare Te Konsoliduara 5

PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA 2022

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

(të gjitha shumat në lekë)

		31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
AKTIVET	**Shënime**		
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	48,928,765,928	54,375,608,977
Aktive afatgjata jomateriale	7	178,449,077	253,657,891
Aktive me të drejtë përdorimi	8	28,038,847	
Aktive afatgjata financiare	9	11,471,758	12,873,258
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	11	8,787,768,309	9,236,307,418
Totali i aktiveve afatgjata		**57,934,493,919**	**63,878,447,544**
Aktivet Afatshkurtra			
Inventarë	10	714,637,057	692,633,679
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	11	12,386,744,460	10,772,713,147
Aktive afatshkurtra financiare	9	20,815,750	20,230,000
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	12	1,564,988,039	1,613,000,385
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	13	4,706,171,573	3,744,588,000
Totali i aktiveve afatshkurtra		**19,393,356,879**	**16,843,165,211**
Totali i aktiveve		**77,327,850,798**	**80,721,612,755**
Kapitali neto dhe detyrimet			
Kapitali			
Kapitali aksionar	14	25,055,608,000	22,146,576,634
Rezerva ligjore	14	822,807,118	789,775,831
Rezerva rivlersimi	14	5,421,483,544	7,858,369,996
Rezerva të tjera	14	13,868,508	517,627,527
Fitime të pashpërndara		453,195,480	1,778,541,985
Fitimi i Vitit		907,587,774	673,888,998
Totali i kapitalit për pronarin		**32,674,550,424**	**33,764,780,971**
Kapital i pakicës	14	106,875,000	106,875,000
Rezerva te tjera të pakicës	14	(202,646)	(60,602)
Fitime të pashpërndara të pakicës		(13,937,127)	(673,858)
Fitimi i Vitit		(22,237,162)	(13,263,269)
Total interesat jo-kontrolluese		**70,498,065**	**92,877,271**
Totali i kapitalit aksionar		**32,745,048,489**	**33,857,658,242**
Detyrimet afatgjata			
Huatë afatgjata	15	13,418,044,467	15,143,081,232
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	16	3,417,124,425	2,129,659,442
Grantet	17	1,155,575,856	1,165,183,962
Detyrimi i qirasë	8	26,991,103	
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	18	781,655,599	1,419,824,652
Totali i detyrimeve afatgjata		**18,799,391,450**	**19,857,749,288**
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	16	9,959,035,190	9,639,059,577
Parapagimet nga klientë	19	260,796,227	104,488,846
Të ardhura të shtyra	20	87,472,993	68,597,443
Hua afatshkurtër	15	15,143,428,546	17,062,895,119
Detyrimi i qirasë	8	3,359,918	
Tatim fitimi	28	329,317,985	131,164,240
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**25,783,410,859**	**27,006,205,225**
Totali i detyrimeve		**44,582,802,309**	**46,863,954,513**
Totali i kapitalit neto dhe pasiveve		**77,327,850,798**	**80,721,612,755**

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare te konsoliduara.

Pasqyrat financiare te konsoliduara u aprovuan më 24 Prill 2023 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Administratori Skerdi Drenova	Drejtori i Drejtorisë Ekonomike Artur Kurti	Shefe e sektorit të Kontabilitetit dhe Taksave Arjola Qirko

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

	Shenime	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	21	5,882,286,134	5,759,913,039
Të ardhura nga alokimet e kapaciteteve	21	1,829,594,040	1,151,131,569
Te ardhura nga disbalanca	21	2,992,902,683	1,864,557,643
Të ardhura të tjera	21	158,252,284	146,801,886
Total të ardhura nga veprimtaria e shfrytëzimit		**10,863,035,141**	**8,922,404,137**
Shpenzime per veprimtaritë e shfrytëzimit			
Shpenzime për materiale	22	(116,746,178)	(88,326,148)
Kosto transmetimi	23	(3,881,270,568)	(2,837,009,497)
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	24	(931,365,649)	(815,296,924)
Shpenzime të personelit	25	(1,255,997,685)	(1,264,581,294)
Renia në vlerë, zhvleresimi dhe amortizimi	6,7,8	(2,255,972,874)	(2,395,581,653)
Humbje nga renia ne vlere e aseteve	6,7	(2,596,653,373)	-
Provigjione/fshirje të llogarive	26	123,298,001	(572,101,523)
Total i shpenzimeve nga veprimtaritë e shfrytëzimit		**(10,914,708,326)**	**(7,972,897,039)**
Fitimi nga veprimtarite e shfrytezimit		**(51,673,185)**	**949,507,098**
Shpenzime interesi	27	(447,486,322)	(487,494,972)
Kostot financiare neto	27	1,326,350,679	460,044,464
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare, neto		**878,864,357**	**(27,450,508)**
Fitimi para tatimit		**827,191,172**	**922,056,590**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimit	28	(580,009,613)	(282,715,808)
Shpenzimet/(të ardhurat) e tatimit të shtyre	18	638,169,053	21,284,948
Fitimi pas tatimit		**885,350,612**	**660,625,730**
I cili i përket:			
OST sha me 57.25% aksione		907,587,774	673,888,998
Interesat e pakicës me 42.75% aksione		(22,237,162)	(13,263,268)
Te ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse:		(439,590,620)	(583,488,339)
Totali të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		**445,759,992**	**77,137,391**

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare te konsoliduara.

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali Nenshkruar	Rezerva nga rivleresimi	Rezerva Ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi i pashperndare	Totali kapitalit	Interesat e pakices	Totali I kapitalit aksionar
Gjendja me 31 dhjetor 2020	21,335,542,634	8,481,302,130	762,528,029	230	1,740,151,451	32,319,524,474	106,201,142	32,425,725,616
Fitimi neto per periudhen ushtrimore					673,888,998	673,888,998	(13,263,269)	660,625,729
Shperndarja e fitimit te vitit 2020			27,247,802	517,708,244	(544,956,046)			
Rritje kapitali vendimi I Asamblese se Pergjithshme nr 21 date 24/03/2021	811,034,000			209		811,034,209		811,034,209
Kontabilizimi I vleresimit te huave		(39,585,554)				(39,585,554)		(39,585,554)
Realizimi I rezerves se rivleresimit		(583,346,580)			583,346,580			
Rezerva perkthimi				(81,156)		(81,156)	(60,602)	(141,758)
Gjendja me 31 dhjetor 2021	22,146,576,634	7,858,369,996	789,775,831	517,627,527	2,452,430,983	33,764,780,971	92,877,271	33,857,658,242
Fitimi neto per periudhen ushtrimore					907,587,774	907,587,774	(22,237,162)	885,350,612
Shperndarja e fitimit te vitit 2021			33,031,287	627,594,442	(660,625,729)			
Rritje kapitali vendimi I Asamblese se Pergjithshme	2,909,031,366			(1,131,163,239)	(1,777,868,127)			
Kontabilizimi I testit te zhvleresimit te aktiveve afatgjata materiale		(2,053,042,051)				(2,053,042,051)		(2,053,042,051)
Kontabilizimi I vleresimit te huave		55,413,952				55,413,952		55,413,952
Realizimi I rezerves se rivleresimit		(439,258,353)			439,258,353			
Rezerva perkthimi				(190,222)		(190,222)	(142,044)	(332,266)
Gjendja me 31 dhjetor 2022	25,055,608,000	5,421,483,544	822,807,118	13,868,508	1,360,783,254	32,674,550,424	70,498,065	32,745,048,489

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Parasë

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	**827,191,172**	**922,056,590**
Rregullime për:		
Amortizimin e aktiveve	2,255,972,874	2,395,581,653
Humbje nga renia ne vlere e aseteve	2,596,653,373	-
Humbje nga rënia në vlerë e llogarive te arketueshme	(123,298,001)	572,101,523
Të ardhura jomonetare nga grantet	(62,931,913)	(107,297,679)
Te ardhura nga interesi	(391)	(101)
Shpenzime interesi	447,486,322	487,494,972
Fitime neto nga kursi i këmbimit	(1,380,081,432)	(452,829,573)
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:		
Parapagime për furnitorë	48,012,346	(1,079,426,624)
Inventarë	(70,699,901)	(53,025,925)
Llogari të arkëtueshme tregtare e të tjera	182,990,957	(5,250,684,804)
Llogari të pagueshme tregtare e të tjera	433,934,432	4,475,513,759
Parapagime nga kliente	156,307,381	27,028,896
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	**4,484,346,047**	**1,014,456,097**
Interes i paguar	(1,086,949,798)	(43,249,545)
Tatim fitimi i paguar	(250,691,628)	(125,320,668)
Flukset neto të parasë gjeneruar nga aktivitetet operative	**3,973,895,793**	**1,767,942,474**
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(2,732,551,609)	(2,893,592,776)
Vlera e AAM dhe inventareve te nxjera jashte perdorimi	118,153,783	1,389,573
Shlyerje të kredive të paleve të treta	815,750	230,000
Interesa të arkëtuar	391	101
Flukset neto të parasë përdorur në aktivitetet investuese	**(2,613,581,685)**	**(2,891,973,102)**
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese		
Të hyra nga huamarrje afatgjata	1,250,690,018	1,428,140,304
Shlyerje të huamarrjeve	(1,694,133,940)	(305,754,256)
Shlyerje qiraje	(8,610,420)	
Te hyra nga grantet	53,323,807	316,479,400
Flukset neto të parasë të gjeneruara në aktivitetet financuese	**(398,730,535)**	**1,438,865,448**
Rritje / (Rënie) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre	**961,583,573**	**314,834,820**
Mjetet monetare në fillim të vitit financiar	**3,744,588,000**	**3,429,753,180**
Mjetet monetare në fund të vitit financiar	**4,706,171,573**	**3,744,588,000**

Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve Monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare te konsoliduara.

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare Te Konsoliduara

1. Informacion i përgjithshëm

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a një Shoqëri publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit.

Administratori i Shoqërisë është Z. Skerdi Drenova. Shoqëria është e rregjistruar me NIPT K42101801N.

Shoqëria u krijua në korrik të vitit 2004 bazuar në Vendimin nr. 797 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 4 dhjetor 2003. Në bazë të këtij vendimi Shoqëria u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh. a ("KESH") me kapitali fillestar prej 2,000 mijë Lekë. Ndarja nga KESH u krye bazuar në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 30 qershor 2006. Shoqëria përgatiti pasqyra financiare te konsolidura si një njësi ekonomike e veçantë duke filluar prej 1 korrik 2006 dhe jo prej vitit 2004 kur nisën të kryheshin transaksionet e para të Shoqërisë. Në vitin 2006 Shoqëria mori liçencën për transmetim energjie nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri dhe në vijim nënshkroi një marrëveshje për shërbime transmetimi me KESH Bazuar në urdhrin nr. 329 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes ('Ministria') datë 9 maj 2008, pronësia e OST iu transferua Ministrisë. Me anë të urdherit numer 10540/17 të Ministrisë, Shoqëria, prej datës 1 janar 2008 filloi të faturonte shërbimet e saj, aktivitet i cili me parë kryhej nepërmjet KESH.

Shoqëria aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet 6 Njësive Operative (me qendër në Shkodër, Burrel, Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë), Njësia e Mirëmbajtjes së Transmetimit (me qendër në Tiranë) dhe Administrata Qëndrore e cila është edhe selia e shoqerise me adresë Autostrada Tiranë – Durrës, Km 9 Yrshek Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike. OST, është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Me Vendimin nr. 12 datë 08.09.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., si dhe me Vendimin nr. 130 datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratuan pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar; si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.

Në datën 05 Tetor 2020, përfaqësuesit ligjorë të OST sh.a. dhe KOSTT sh.a., firmosën Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX.

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX, është regjistruar tashmë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë me NIPT M02223006B. Objekti kryesor I aktivitetit të shoqërisë është krijimi, menaxhimi dhe administrimi I tregut të organizuar të energjisë elektrike, nëpërmjet platformës së tregut në bazë të ditës në avancë dhe brenda të njejtës ditë.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të OST sh.a. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë, duke përfshirë edhe ndryshimet gjatë vitit, janë të përfshira në Shënimin 4.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare te kosoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të cilat maten me vlerën e rivlerësuar dhe huave afatgjata të cilat njihen me vlerën e drejte ne momentin fillestar dhe me pas maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

2.3 Baza e konsolidimit

- *Filialet*

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston atëherë kur Grupi ka fuqinë të drejtojë politikat financiare dhe operacionale të një njësie, me qëllim që të përfitojë nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit, merren në konsideratë të drejtat potenciale votuese që janë aktualisht në fuqi. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke u bazuar ne politika kontabël uniforme për transaksione të ngjashme dhe çështje të tjera në kushte të njëjta

- *Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit*

Tepricat brenda grupit, dhe ndonjë shumë e parealizuar e të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet brenda grupit (përvec fitimeve ose humbjeve nga këmbimet në monedha të huaj), janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e parealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

2.4 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare te konsoliduara paraqiten në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Standarde dhe interpretime të reja

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.
Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Grupit.

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare te konsoliduara.

2.5.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022

Disa standarde të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive nga 1 janari 2022 dhe që janë miratuar nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Shoqërisë. Për këtë arsye informacioni shpjegues lidhur me këto Standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Shoqërisë.

2.5.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që

Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Shoqëria planifikon ti aplikojë këto ndryshime në datat kur këto standarde do të jenë efektive.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri janë publikuar, por ende nuk janë efektive:

SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

Amendamentet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Amendamentet në SNRF 17 dhe SNRF 4)

Referencat në Kuaderin Konceptual

Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)

Kontratat e ndertimit - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)

Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF-së 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)

Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshime në SNK 1)

Tatimi i shtyrë i lidhur me Aktivet dhe Detyrimet nga një transaksion i vetëm

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë në periudhën e zbatimit fillestar.

3. Përdorimi i gjykimeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare te kosnoliduara drejtimi ka ushtruar gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë prej këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhat e ardhme.

3.1 Gjykimet

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efekte materiale në vlerat e njohura në pasqyrat financiare te konsoliduara është përfshirë në shënimet si më poshtë:

- Shënimi 4(d)- aktivet afatgjata materiale: zgjedhja e metodës së rivlerësimit;
- Shënimi 4(e)-instrumentat financiare.

3.2 Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimeve

Informacioni rreth supozimeve dhe pasigurive të vlerësimeve që kanë një risk të konsiderueshëm për të sjellë një rregullim material në fund të vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 është përfshirë më poshtë dhe në shënimet vijuese:

- Shënimi 4.k dhe 6.ii - Testi i zhvlerësimit: supozimet kyçe që janë bazë e vlerës së rikuperueshme;
- Shënimi 5: Instrumentat Financiare-Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut edhe rritja e riskut te kreditimit;
- Shënimi 6: i Matja e vlerës së drejtë – hierarkia e vlerës së drejtë;
- Shënimi 28: Shpenzimi i tatimit mbi fitimit

3. Përdorimi i gjykimeve (vazhdim)

3.2 Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimeve (vazhdim)

Matja e vlerës së drejtë

Një numër politikash kontabël dhe shënimesh shpjeguese të shoqerise kërkojnë matje sipas vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare.

OST ka bashkëpunuar me vlerësues të pavarur për të përcaktuar matje të vlerës së drejtë, përfshirë vlerën e drejtë të Nivelit 3 për aktivet jo-financiare. Drejtimi vlerëson evidencën e marrë nga palët e treta për të mbështetur përfundimin se këto vlerësime përputhen me kërkesat e SNRF, duke përfshirë edhe nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilin vlerësime të tilla duhen klasifikuar.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë që nuk shiten në një treg aktiv përcaktohet nga teknikat e vlerësimit. Shoqëria përdor gjykimin për të zgjedhur një numër te ndryshëm metodash dhe bën supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet aktuale të tregut në çdo përllogaritje apo datë raportimi. Shoqëria përdor analizën e skontuar të flukseve të parasë për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk shiten në tregjet aktive.

Kur një aktiv ose detyrim matet me vlerën e drejtë, Shoqeria përdor të dhëna tregu të vëzhgueshme për sa është e mundur. Vlerat e drejta janë të kategorizuara në nivele të ndryshme hierarkie në bazë të të dhënave të përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë:

- Niveli 1: çmimi i kuotuar (i pa rregulluar) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta apo identike;
- Niveli 2: të dhëna të tjera përveç çmimit të kuotuar të përfshirë ne Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme, drejtpërdrejt (p.sh. çmimi) ose indirekt (p.sh. ato që derivojnë nga çmimi) për aktivin ose detyrimin;
- Niveli 3: të dhëna për aktivin ose detyrimin të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna tregu të vëzhgueshme (të dhëna të pavëzhgueshme).

Nëse të dhënat e përdorua për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi janë në nivele të ndryshme hierarkie, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj në nivelin më të ulët hierarkik ku përfshihen të dhënat kryesore që përdoren për matjen e vlerës së drejtë.

Shoqeria i njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

Informacione të mëtejshme për supozimet e bëra në matjen e vlerës së drejtë janë përfshirë në Shënimin 5.

Rritja e konsiderueshme në riskun e kreditit

Siç shpjegohet dhe më poshtë, humbjet e pritshme të kreditit maten si një provizion i barabartë me humbjen e pritshme 12-mujore per instrumentet e fazës 1, ose humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetës per instrumente të fazës 2 ose 3. Një instrument financiar lëviz në fazën 2 kur risku i tij i kreditit është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. SNRF 9 nuk e përcakton çfarë nënkupton një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kreditit.

Për të vlerësuar nëse risku i kreditit të një instrumenti është rritur ndjeshëm apo jo, Shoqëria merr parasysh informacion cilësor dhe sasior të arsyeshëm dhe të parashikuar. Bazuar në vlerësimin e menaxhimit "Qasja e përgjithshme" është aplikuar për llogaritë e arkëtueshme me OSHEE sh. a dhe KESH sh.a.

Duke u bazuar në faktin se OSHEE është një entitet shtetëror, me një mbështetje të madhe nga qeveria shqiptare, vlerësojmë që risku i kreditit të kompanisë është i ndërlidhur pozitivisht me riskun e sovranitetit të Shqipërisë. Përveç kësaj, ne e konsiderojmë qeverinë shqiptare si suportues të OSHEE në rast vështirësie financiare, duke e ulur riskun e kreditit. Qeveria është plotësisht e angazhuar për të përmirësuar efikasitetin, kapacitetin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare.

3. Përdorimi i gjykimeve (vazhdim)

3.2 Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimeve (vazhdim)

Rritja e konsiderueshme në riskun e kreditit (vazhdim)

Me 17 dhjetor 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomise se bashku me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise miratuan "Planin e masave per uljen e detyrimeve te detyrueshme ne sektorin e energjise elektrike"

Me 15 prill 2021 ndermjet OSHEE sha dhe OST sha eshte firmosur "Mareveshja per pagesen e detyrimeve te prapambetura" ne shumen 9,687,768,309 leke. Marreveshja perfshin nje skeme pagese duke filluar nga data 1 korrik 2021 per nje shume minimale prej 360 milione leke ne vit ose 6.5% te faturave aktuale vjetore, te cilat do te shlyejne tepricat e mbartura. Bazuar ne kete mareveshje shumat totale te papaguara Nga OSHEE sha kundrejt OST sha do te shlyhen deri ne vititn 2047.

Ndonëse në balancën e arkëtueshme nga OSHEE përfshihen fatura të cilat janë të pashlyera për një periudhë kohore që tejkalon 90 ditë, e cila përmendet në SNRF 9 si kriter e cila do ta klasifikonte OSHEE në Fazën 3 dhe do të kërkonte një provigjon 100% të balancës, ne kemi gjykuar që nuk është mjaftueshëm e arsyeshme për të klasifikuar OSHEE në fazën 3 për shkak të arsyeve:

- për shkak të industrisë në të cilën OST dhe OSHEE operojnë;
- për shkak të marrëveshjes në fuqi midis palëve për pagesën me këste për të gjithë balancën.
- shumat e faturuara nga ana e OST sha kundrejt OSHEE sha per tregtimin e energjise per periudhat aktuale shlyhen ne kohe

Duke mare ne konsiderate sa me lart, kriteret e mospagimit do te ndodhnin vetem nese politika e qeverise do te duhej te hiqte dore nga keto borxhe dhe do t'i kerkonte OST te ruane humbjen e saj. Prandaj, teprica e papaguar nga OSHEE lidhur me llogarite rrjedhese eshte klasifikuar ne Fazen 1. Megjithate, duke qene se kushtet e kontrates (kushti per marrjen e nje minimumi prej 360 milione leke ne vit) nuk u plotesua deri me dhjetor 2021, balanca e papaguar sipas mareveshjes eshte klasifikuar ne Fazen 2 sipas SNRF 9 dhe jane llogaritur humbjet e pritshme te kredise gjate jetes se aktivit.

Sipas klasifikimit të riskut të kreditit të KESH-it, (megjithëse ka një balancë të prapambetur që tejkalon periudhën prej 90 ditë) ne kemi konsideruar të klasifikohet në Fazën 1 për arsyet e mëposhtme:

- KESH është një entitet shtetëror dhe garantues I saj eshte qeveria shqiptare;
- Nuk është e mundur që KESH të hyjë në falimentim;
- Nga qeveria shqiptare eshte zbatuar "Plani I masave per uljen e detyrimeve ne sektorin e energjise elektrike"

Gjithashtu, me date 05/10/2021 ndermjet OST sha dhe KESH sha eshte firmos "Mareveshja per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura" spas se ciles detyrimi I OST sha do te shlyehet deri me korrik 2026 sipas nje skeduli te percaktuar ne kete mareveshje. Per kete detyrim do te zbatohet e njejta qasje si ajo e mareveshjes me OSHEE ku balanca do te matet me koston e amortizuar.

Klasifikimi në fazën 2 për KESH do të ishte i aplikueshëm në rast se:

- Cdo ent ne pronesi te qeverise mund te falimentoje;
- do të pritej një ndryshim i konsiderueshëm në rezultatet operative të KESH si rënie e të ardhurave dhe marzheve të fitimit për shkak të:
  - uljes së përgjithshme të konsumit të energjisë në vend;
  - ne rast se performance financiare e njesive do te perkeqesohe per shkak te faktoreve te ndryshem nga moti.

Klasifikimi në fazën 3 do të ishte i aplikueshëm në rast se:

- do të kishte plane për OSHEE dhe KESH për t'u dhënë me koncesion;
- ose nëse OSHEE/KESH do të rrezikonin të falimentonin për shkak të vështirësive financiare të mëdha.

3. Përdorimi i gjykimeve (vazhdim)

3.2 Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimeve (vazhdim)

Llogaritja e provizionit

Gjatë matjes së humbjes së pritshme të kredisë, Shoqëria përdor informacion të arsyeshëm dhe të parashikuar, i cili bazohet në supozimet për lëvizjet e ardhshme të faktorëve të ndryshëm nxitës ekonomikë dhe se si këto faktorë do të ndikojnë tek njëri-tjetri.

Humbja nga mos shlyerja është një vlerësim i humbjes që vjen nga mospagimi, duke u bazuar në diferencën midis fluksit monetar kontraktual që paguhet dhe asaj që pritet të merret. Implementimi i "Qasjes së thjeshtuar" është përdorur për aktivet financiare dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera. Analiza e vjetersisë nuk është kryer e ndarë në 1-30 ditë, 30-60 ditë, 69-90 ditë edhe më shumë se 90 ditë, prandaj janë identifikuar vetëm gjendjet që nuk janë paguar për më shumë se 365 ditë.

Në shumicën e rasteve, këto balanca përbëhen nga klientët që janë në një proçes gjyqësor me Shoqërinë. Në lidhje me aktivet financiare, këto balanca përfshijnë kreditë e dhëna drejt punonjësve. Prandaj, Manaxhimi ka parë të arsyeshme të aplikojë një normë të humbjes prej 100% për të gjitha balancat e papaguara mbi 365 ditë. Ndërkohë që duke u bazuar në një normë të humbjes së kreditit historik, një normë prej 1.94% është aplikuar në balancat që janë nën 365 ditë pa paguar.

Humbja e pritshme e kredise llogaritet vecmas per te arketueshmet tregtare nga klientet dhe debitoret e tjere me nje norme te humbjes se kreditit 8.64% me 31 dhjetor 2022. (2021: 5.64%)

Mundësia e mosshlyerjes përbën një faktor kyç në matjen e humbjes së pritshme të kreditit. Mundësia e mosshlyerjes është një vlerësim i mundshëm i mospagesës në një periudhë të caktuar kohore, llogaritja e të cilës përfshin të dhëna historike, supozime dhe pritshmëri për kushtet e ardhshme.

Nëse normat e humbjes së pritshme të kreditit mbi llogaritë e arkëtueshme dhe te tjera te arketueshme me më pak se 365 ditë vonesë, do të kishin qenë 1% më të larta (apo më të ulta) më 31 dhjetor 2021, provizioni i llogarive të arkëtueshme do të rritej/(ulej) me 14,127,270 Lekë (2021: 18,956,415 Lekë).

SNRF 9 gjithashtu kërkon një qasje të thjeshtuar për matjen e provizionit, në shumë të barabartë përgjatë gjithë jetës së llogarive të arkëtueshme dhe të tjera, si dhe aktiveve financiare. Impakti në aktive financiare, si dhe në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre është jomaterial, ndaj Shoqëria ka vendosur të mos i përfshijë në pasqyrat financiare që lidhen me këto zëra.

4. Politika të rëndësishme kontabël

OST sh.a ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare te konsoliduara.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos të amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës.Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Inventari

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e kostos specifike për secilin artikull dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së tyre në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur kostot e vlerësuara të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

(c) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jo-materiale të blera nga Grupi janë paraqitur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara të rënies në vlerë. Shpenzimet e mëpasshme të aktiveve afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të aktiveve specifike me të cilat lidhen.

Të gjitha shpenzimet e tjera rregjistrohen në momentin që ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktiveve. Jeta e dobishme e vlerësuar është 5 vite.

(d) Aktivet afatgjata materiale

- *Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjata materiale në pasqyren e pozicionit financiar janë paraqitur me vlerën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit së cilës i zbritet amortizimi i akumular dhe çdo humbje pasardhëse e akumuluar nga rënia e vlerës.

Rivlerësimet janë kryer me rregullsi të mjaftueshme, të tillë që vlerat kontabël nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato që do të përcaktoheshin duke përdorur vlerën e drejtë në fund të çdo periudhe raportimi.

Çdo tepricë nga rivlerësimi njihet në të Ardhurat e tjera Gjithëpërfshirëse (‘ATGj’) me përjashtim të masës në të cilën teprica anullon rëniet në vlerë të mëparshme të rivlerësimit të të njëjtit aktiv, rast në të cilin kreditimi njihet në fitim ose humbje.

Çdo rënie në vlerë nga rivlerësimi njihet në fitim ose humbje, me përjashtim të masës që kjo anullon një tepricë të mëparshme të rivlerësimit të të njëjtit aktiv, rast në të cilin debitimi njihet në ATGj. Për këtë arsye, tepricat dhe rëniet në vlerë nuk mund të netohen edhe brenda të njëjtës klasë aktivesh. Rezerva e rivlerësimit transferohet tek fitimet e mbartura përgjatë përdorimit të aktivit.

Nëse pjesë të konsiderueshme të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë ato njihen si aktive të ndara më vete (komponentë kryesorë) në aktivet afatgjata materiale.

Ndërtimet në proces mbahen me kosto, pakësuar me humbjet e njohura nga zhvlerësimi (nëse ka) dhe klasifikohen në kategoritë e duhura të aktiveve afatgjata materiale kur përfundohen dhe janë të gatshme për përdorim. Kosto përfshin të gjithë shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me përftimin e aktivit. Këto shpenzime përfshijnë tarifat profesionale, dhe për aktivet e kualifikuara kostot e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikat kontabël të shoqerise.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material njihet në fitim ose humbje.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Aktivet afatgjata materiale(vazhdim)

- *Shpenzimet e mëpasshme*

Shpenzimet e mëpasshme të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohen nëse pritet që Grupi të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga këto shpenzime.

- *Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi llogaritet për të anulluar shumat e rivlerësuara të aktiveve afatgjata materiale duke i zbritur vlerën e mbetur sipas metodës lineare të amortizimit, përgjatë jetës së dobishme dhe njihet në fitim ose humbje.
Jetët e dobishme të aktiveve afatgjata materiale për periudhen aktuale dhe atë krahasuese janë si më poshtë:

	2022	2021
• Përmirësimet e tokës dhe ndërtesat	5 - 65	5 - 65
• Instalime teknike, pajisje dhe makineri	3 - 55	3 - 55
• Mjete transporti	4 - 14	4 - 14
• Pajisje zyre dhe informatike	5 - 15	5 - 15

Toka dhe ndërtimet në proces nuk amortizohen.

Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

Grupi bazuar ne kerkesat e SNRF 13 “Matja me vleren e drejte” ka kryer testin e zhvleresimit te aktiveve afatgjata materiale. Testi i zhvlerësimit për aktivet afatgjata materiale është në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 36 “Zhvlerësimi i aktiveve”. Ne bazë të llogaritjeve përkatëse, vlera e rikuperueshme (vlera në përdorim) e aktiveve fikse të OST që rezulton më 31/12/2022, është më e ulët se vlera kontabël, duke treguar kështu një zhvlerësim ne shumen 4,650 milionë lekë (shënimi 6 dhe shënimi 7).

(e) Instrumentet financiarë

- *Aktive financiare joderivative*

OST sh.a fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen.Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

OST çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga shoqeria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Grupi ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

- *Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjerat*

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuara në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Instrumentet financiarë (vazhdim)

- *Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjerat (vazhdim)*

Shoqëria gjithmonë mat provizionin për llogaritë e arkëtueshme në shumë të barabartë me humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetëgjatësisë. Humbjet e pritshme për llogaritë e arkëtueshme përllogariten duke përdorur një matricë provizioni me referencë nga eksperienca e kaluar e mosshlyerjes nga ana e klientit dhe nga një analizë e pozicionit aktual financiar të tij, e rregulluar për faktorë që janë specifikë për klientin, kushtet ekonomike të përgjithshme të industrisë në të cilën klientët operojnë dhe një vlerësim i rrjedhës së parashikuar dhe aktuale të kushteve në datën e raportimit.

Shoqëria ka njohur një provizion 100% kundrejt të gjitha llogarive të arkëtueshme mbi 365 ditë vonesë, sepse eksperienca historike ka treguar se këto llogari janë përgjithësisht të parekuperueshme ndersa per llogarite e arketueshme me me pak se 365 dite vonese eshte perdorur norme humbje 5.6%.

Shoqëria e anullon një llogari të arkëtueshme kur ka informacion që tregon se klienti është në vështirësi financiare dhe nuk ka një perspektivë realiste të rimëkëmbjes, p.sh. kur klienti është proces likujdimi ose ka hyrë në procedura të falimentimit, ose kur një llogari e arkëtueshme është mbi dy vjet e pashlyer, cilado që të ndodhë më herët.

- *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalente e tyre përfshijnë mjetet monetare gjendje si dhe depozitat me afat fillestar maturimi jo më të madh se tre muaj. Llogaritë debitore bankare që përbëjnë një pjesë të menaxhimit të mjeteve monetare të shoqerise, përfshihen në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në pasqyrën e flukseve monetare.

- *Detyrimet financiare joderivative*

Grupi fillimisht i njeh detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Grupi e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen ose anullohen apo përfundojnë. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare joderivative të shoqërisë janë si vijojnë: hua dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin.

Për huatë e marra drejtpërdrejt nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit, norma e tregut përcaktohet duke u nisur nga perspektiva e bankave të zhvillimit dhe përgjithësisht është e barabartë me normën e kontratës, për shkak se bankat e zhvillimit përbëjnë tregun për shoqerine.

Për fondet e financuara fillimisht nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit dhe më pas të nën-huazuara tek OST sh.a nga Qeveria apo KESH, norma e tregut fillimisht është përcaktuar duke iu referuar normave të ofruara nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit, me diferencën midis vlerës së drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit,të konsideruar si kontribut nga aksionari dhe të kontabilizuar si rezervë rivlerësimi në kapital.

Për huamarrje të tilla, përdoret gjykimi i menaxhimit në përcaktimin se Qeveria apo KESH janë duke vepruar në cilësinë e aksionarit kur nën-huazojnë fondet për OST sh.a.

Pas njohjes fillestare këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Kostot e huamarrjes

Grupi kapitalizon kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar si pjesë e kostos së atij aktivi.

(g) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Grupi ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi i zbritjes në kohë njihet si kosto financiare.

(h) Grantet

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Grupi do të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur atyre. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

(i) Kapitali aksionar dhe dividendët

- *Kapitali aksionar*

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

- *Dividendët*

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin njihet në pasqyrat financiare te konsoliduara të shoqerise si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionari i OST sh.a.

(j) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësimin e tyre. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivet që nuk mund të testohen individualisht janë grupuar bashkë në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse hyrëse të parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesisht të pavaruara nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve (njësia e gjenerimit të parasë ose 'NJGJP').

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e NJGJP-së së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NJGJP-të shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (grupin e njësive) në mënyrë përpjestimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritej amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Modeli i zhvlerësimit në SNRF 9 bazohet në modelin e humbjeve të pritshme ("ECL") dhe zëvendëson modelin e humbjeve të pësuara të SNK 39, duke rezultuar në njohjen e një provigjioni humbjesh përpara se të ndodhë humbja e kredisë. Sipas kësaj qasje, Shoqëria merr në konsideratë kushtet aktuale dhe informacionin e arsyeshëm që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme gjatë vlerësimit të humbjeve të pritura të kredisë. SNRF 9 përcakton një "Qasje të përgjithshme" për zhvlerësimin. Modeli ECL zbatohet për instrumentet financiare ë regjistruara me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Parimi udhëzues i modelit ECL është të pasqyrojë modelin e përgjithshëm të përkeqësimit, ose përmirësimit, në cilësinë e kredisë së instrumenteve financiare. Një aktiv financiar i mbajtur jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse të dhëna objektive tregojnë se ka ndodhur një ngjarje e cila ka sjelle humbje pas njohjes fillestare te aktivit, dhe kjo ngjarje ka pasur efekt negativ mbi flukset monetare të parashikuara nga ai aktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme.

Qasja e përgjithshme

Bazuar në "Qasje-n e përgjithshme", një provizion për humbjet e pritshme të kredisë njihet për një instrument financiar nëse ka patur një rritje të konsiderueshme të riskut të kredisë (e matur duke përdorur probabilitetin jetëgjatë të falimentimit) që nga njohja fillestare e aktivit financiar. Nëse në datën e raportimit, risku i kredisë për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, atëherë njihet një provigjion për humbjet e pritura 12 mujore të kredisë.

Me fjalë të tjera, "Qasja e përgjithshme" ka dy baza për të matur humbjet e pritura të kredisë:

a) Humbja e pritur 12 mujore e kredisë është pjesa e humbjeve të pritura të kredisë gjatë gjithë jetës që paraqesin humbjet e pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e falimentimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.
b) Humbjet e pritura gjatë gjithë jetës është humbja e pritur e kredisë që rezulton nga të gjitha ngjarjet e mundshme të falimentimit gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

Në përcaktimin e zhvlerësimit sipas "Qasjes së thjeshtuar", Shoqëria përdor humbjen historike të probabilitetit të mospagimit, kohën e arkëtimit dhe shumën e humbjes së shkaktuar. Kjo normë më pas korrigjohet sipas gjykimit të drejtuesve, nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredidhënies, janë të tilla që, humbjet aktuale ka të ngjarë të jenë më të mëdha ose më të vogla se sa sugjerohet nga tendencat historike.

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari provizioni që pakëson llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme sjell zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim rimerret në fitim humbje.

(l) Njohja e të ardhurave

Kompania është e përfshirë në transmetimin e energjisë, si dhe kryerjen e shërbimeve të lidhura.Të ardhurat nga shërbimet e transmetimit njihen kur transmetimi i energjisë ndodh, bazuar në sasinë e vërtetë të energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes, matur në pikën e shpërndarjes.

Të ardhurat përfaqësojnë vlerën fikse ose të përcaktueshme të çfare është marrë në këmbim ose është e arkëtueshme. Të ardhurat njihen me shumat e faturuara për konsumatorët dhe përjashtojnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, zbritjet dhe skontimet.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e investuara dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje kur maturohen, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen mbi bazë neto. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi kreditë. Kostot e huave që nuk janë direkt të lidhura me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv.

(n) Tatim mbi fitim

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përveç rasteve kur lidhen me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi mbi fitimin e periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose arkëtuar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, dhe që nuk ndikon fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Grupi pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyer vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që priten të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës në baza neto, ose aktivet dhe pasivet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Taksat e tjera që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Grupi njihen në të njëjtën kohë si detyrimi për të paguar dividendin e lidhur me të.

Një aktiv tatimor i shtyrë për humbje tatimore të papërdorura, njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

(o) Qiratë

Qiratë 'kapitalizohen' duke njohur vlerën aktuale të pagesave të qirasë dhe duke i paraqitur ato ose si aktive qiraje (aktive me të drejtë përdorimi). Nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, një kompani njeh gjithashtu një detyrim financiar që përfaqëson detyrimin e saj për të bërë pagesat e qirasë në të ardhmen.

SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e qirasë operative lineare për ato qira që zbatojnë SNK 17 me një tarifë amortizimi për aktivin e qirasë (të përfshirë në kostot e funksionimit) dhe një shpenzim interesi mbi pasivin e qirasë (përfshirë në kostot financiare).

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(o) Qirate (vazhdim)

Duke zbatuar SNRF 16, një kompanie i kërkohet që: (a) të njohë aktivet dhe detyrimet e qirasë në bilanc, të matura fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të qirasë tëpashmangshme; (b) njohin zhvlerësimin e aktiveve të qirasë dhe interesin mbi detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së qirasë; dhe (c) të ndajë shumën totale të mjeteve monetare të paguara në një pjesë të principalit (të paraqitur në kuadër të aktiviteteve financiare) dhe interesit (zakonisht të paraqitur në kuadër të aktiviteteve operative ose financiare) në pasqyrën e fluksit monetar.

SNRF 16 nuk kërkon që qiramarrësi të njohë aktivet dhe detyrimet për (a) qiratë afatshkurtra (d.m.th. qiratë prej 12 muajsh ose më pak) dhe (b) qiratë e aktiveve me vlerë të ulët (për shembull, një qira e një kompjuteri personal)

(p) Përfitimet e punonjësve

- *Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit*

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Grupi është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga Qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

- *Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës*

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Grupi është e angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur njeh kosto ristrukturimi. Nëse përfitimet nuk pritet të zgjidhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontohen.

(q) Çështjet që lidhen me klimën

Rreziku i krijuar nga ndryshimet e klimes mund te kete ndikim ne pasqyrat financiare te shoqerise. Keto rreziqe perfshijne ndikimin ne vjetersim me te shpejte sesa koha e pritshme ne vleren e mbetur të aseteve. Çështjet e lidhura me klimën mund të shkaktojnë indikacione se një aktiv (ose një grup asetesh) është zhvlerësuar. Shoqeria do te mare parasysh nëse çështjet e lidhura me klimën kanë një ndikim në planet e biznesit dhe supozimet financiare dhe operacionale të përdorura lidhur me vlerën në përdorim gjatë përcaktimit të shumës së rikuperueshme (p.sh. ne ndikimin e saj tek norma e skontimit, norma e rritjes afatgjatë etj).

Këto çështje, mund të kene efekt në kontratat e qirasë duke qene se aktivi i mare me qera mund te ekspozohet nga kushtet atmosferike duke bere qe shoqeria të rinegociojnë afatin e qirasë dhe të bëjë rimatjen e aktivit të qirasë dhe detyrimit të qirasë.

Gjithashtu, çështjet klimatike mund të ndikojnë në ekspozimin e një njësie ekonomike ndaj humbjeve të kredisë (p.sh. nëse biznesi i kreditorit preket negativisht nga rregulloret e reja mjedisore, ose nëse ka pësuar dëme fizike në aktivet e saj kryesore) dhe rrjedhimisht matjen e ECL.

Këto çështje, mund të kene impakt negativ në fitimet e ardhshme të tatueshme mbi të cilat bazohet njohja e aktiveve tatimore të shtyra. Pritet që plani i biznesit i përdorur për njohjen e aktiveve tatimore të shtyra të bazohet në të njëjtat supozime të përdorura gjatë vlerësimit të shumës së rikuperueshme të aktiveve afatgjata.

Çështjet e lidhura me klimën mund të reflektojnë në njohjen dhe matjen e provizioneve për shkak të një përshpejtimi të ndryshimeve klimatike dhe nevojës për të ndërmarrë disa masa mjedisore më shpejt, lidhur me kontratat të cilat ndikohen nga ndryshimet klimatike dhe mund të ulin potencialisht të ardhurat e njësive dhe/ose të rrisin shpenzimet e saj operative. Rreziqet shtesë ndaj të cilave një njësi ekonomike është e ekspozuar për shkak të vendndodhjes ose aktiviteteve të saj, mund të shkaktojnë gjithashtu detyrime të reja.

Drejtimi vlereson vazhdimisht ndikimin e çeshtjeve të lidhura me klimen në aktivitetin e shoqërisë.

Supozimet mund te ndryshojne ne te ardhmen ne pergjigje te rregulloreve te ardhshme mjedisore dhe rregullatore dhe angazhimeve te reja te mara.

5. Instrumentet financiarë - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut

5.1 Klasifikimet kontabël dhe vlera e drejtë

OST nuk ka paraqitur vlerat e drejta të aktiveve financiare të tilla si të arkëtueshme dhe të pagueshme tregtare afatshkurtër, sepse vlera e tyre kontabël është një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë.

5.1.1 Aktive financiare që nuk maten me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve, të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera të arkëtueshme vlerësohet të jetë e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qënë se janë instrumente afatshkurtër ose që nuk mbartin interes.

5.1.2 Detyrimet financiare që nuk maten me vlerë të drejtë

OST është palë në kontrata për hua afatgjata dhe drejtimi ka kryer analiza për të përcaktuar vlerën e tyre të drejtë.

Tabela e mëposhtme tregon vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të huave në 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

	Më 31 dhjetor 2022		Më 31 dhjetor 2021	
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë	Vlera kontabël	Vlera e drejtë
Huatë	28,561,472,063	28,408,772,096	32,205,976,350	32,575,472,023

Vlera e drejtë është vlerësuar si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën e interesit të huave të ngjashme në datën e raportimit. Normat e interesit të përdorura për të skontuar flukset e ardhshme më 31 dhjetor 2022 janë në intervalin prej 0.84% deri në 5.38% (2021: 0.84% deri 5.38%) dhe janë përcaktuar duke përdorur perspektivën e bankave të zhvillimit.

Normat e tregut në datat e raportimit që janë përdorur në llogaritje, janë përcaktuar duke u bazuar në normat e ofruara nga bankat e zhvillimit. Drejtimi arriti në përfundimin se nuk ka në dispozicion të dhëna publike për tregun që mund të përdoren pa rregullime të rëndësishme në përcaktimin e vlerave të duhura të drejta të huave afatgjata.

Një numër rreziqesh dhe rrethanash ndikojnë në përcaktimin e vlerave të drejta të këtyre instrumenteve financiare, duke përfshirë shumën e instrumentit financiar, maturitetin, klasifikimin e kredive, llojin e interesit, monedhës, qëllimin e kredisë, garancive, mjedisin ekonomik në të cilin palët e instrumentave financiarë veprojnë, dhe vet riskut të mos performimit.

Për shkak të mungesës së të dhënave të drejtpërdrejta të vëzhgueshme të tregut në lidhje me rreziqet dhe rrethanat e këtyre instrumenteve financiare, vlera e drejtë e paraqitur më lart mund të konsiderohet vetëm si e përafërt e arsyeshme për vlerën e drejtë dhe për të përmbushur kriteret për klasifikim në nivelin e tretë të hierarkisë së vlerës së drejtë. Edhe pse Grupi konsideron se vlerat e drejta të vlerësuara janë të sakta, përdorimi i metodologjive dhe supozime të ndryshme mund të rezultojë në vlera të drejta të ndryshme.

5.2 Menaxhimi i riskut financiar

Grupi është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme që vijnë prej aktiveve dhe detyrimeve financiare:

- Risku i *kreditimit*
- Risku i *tregut*
- Risku i *likuiditetit*

Funksioni i menaxhimit të riskut brenda shoqerise kryhet duke marrë në konsideratë risqet financiare (të kredisë, tregut, monedhës, likuiditetit dhe normës së interest), risqet operacionale dhe risqet ligjore. Objektivi kryesor i funksionit të menaxhimit të riskut financiar është të vendosë limite risku, dhe më tej të sigurohet se ekspozimi ndaj risqeve mbahet brenda këtyre limiteve. Funksionet e riskut operacional dhe ligjor janë parashikuar të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar risqet operacionale dhe ligjore. Grupi operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike me zhvillime dinamike.

5. Instrumentet financiarë - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Përshtjellimi i mëtejshëm i saj mund te ketë impakt negativ ne pozicionin financiar të shoqerise. Drejtimi kryen monitorime të rregullta mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe zhvillimeve të tregjeve ndërkombëtare. Bazuar në këtë, drejtimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe kërkon të implementojë masat e duhura në lidhje me riskun e kreditimit, riskun e tregut (kryesisht të normës së interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke limituar kështu efektet e mundshme negative. Për më tepër, OST është financuar nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit apo nën-huazuar nga Qeveria ose palët e lidhura (si KESH). Në këtë mënyrë, OST i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut duke ruajtur pozicione të qëndrueshme kapitali.

5.2.1 Risku i kreditimit

Grupi ekspozohet ndaj riskut të kreditimit, i cili është risku që njëra nga palët në një aktiv financiar të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Ekspozimi kryesor i shoqerise ndaj riskut të kreditimit lind për shkak të të arkëtueshmeve financiare, tregtare dhe të tjera.

Maksimumi i ekspozimit të OST ndaj riskut të kredisë për kategori të aktiveve financiare dhe për kundërparti, përpara kolateraleve dhe shtesave të tjera është si vijon:

Risku i kredise	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare në bankë	4,706,171,573	3,744,588,000
Llogari të arkëtueshme		
- Shoqëri private	1,527,781,540	1,985,646,234
- Shoqëri të zotëruara nga shteti	17,690,290,963	17,890,715,748
Hua dhe llogari të arkëtueshme	32,287,508	33,103,258
Llogari të arkëtueshme nga personeli	4,458,779	141,610
Parapagime per furnitore	1,564,988,039	1,613,000,385
Tvsh e arketueshme	296,948,239	11,303,048
Te tjera	1,655,033,248	121,213,925
Ekspozimi total ndaj riskut të kredisë	**27,477,959,889**	**25,399,712,208**

- *Menaxhimi i riskut të kreditimit*

Grupi ekspozohet ndaj riskut të kreditimit në aktivitetet e tij të përditshme, sepse mundet që klientët e tij të dështojnë në plotësimin e detyrimeve financiare. OST strukturon nivelet e riskut të kreditimit që merr përsipër duke vendosur limite ndaj shumave të pranuara të riskut në lidhje me kundërpartitë. Limitet në nivel të riskut të kreditimit aprovohen rregullisht nga drejtimi. Këto risqe monitorohen mbi baza përsëritëse dhe janë subjekt i rishikimeve vjetore apo edhe më të shpeshta.

- *Përqëndrimi i riskut të kreditimit*

OST ekspozohet ndaj përqëndrimit të riskut të kreditimit. Drejtimi monitoron përqëndrimin e riskut të kreditimit por përballet me vështirësi në aplikimin e praktikave më të mira të politikave të menaxhimit përkundrejt ekspozimit të Shoqërisë ndaj këtij risku. Përqëndrimi kryesor ka të bëjë me OSHEE Sh.a. Në këto kushte, masat e diversifikimit janë të vështira të aplikohen. Më 31 dhjetor 2022, balancat e arkëtueshme nga OSHEE Sh.a përfaqësojnë 64% të ekspozimit maksimal total ndaj riskut të kreditimit (2021: 70%).

Depozitat bankare të shoqërisë mbahen në tetë banka në vend (2021: tetë banka në vend).

- *Të arkëtueshmet e zhvlerësuara*

Të arkëtueshmet për të cilat Grupi përcakton se është e mundshme që nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumat përkatëse në përputhje me termat kontraktualë të marrëveshjes/(ve) zhvlerësohen.

5. Instrumentet financiarë - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.1 Risku i kreditimit (vazhdim)

- ***Të arkëtueshmet e zhvlerësuara (vazhdim)***

Të arkëtueshmet në vonesë por të pa zhvlerësuara më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, lidhen kryesisht me shuma të arkëtueshme nga OSHEE, një entitet i kontrolluar nga qeveria shqiptare, për shitjet e bëra në 2019 dhe vitet paraardhëse.

Lëvizjet në zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendja më 1 janar	921,095,715	348,994,192
Writte off i aktivit financiar me 31 dhjetor	(3,121,332)	-
Humbje nga zhvlerësimi me 31 dhjetor	(123,298,001)	572,101,523
Gjendja më 31 dhjetor	**794,676,382**	**921,095,715**

OST sha ka llogaritur një total provigjonesh prej 3,121,332 lekë në 31 dhjetor 2015 dhe 2016.

Sipas SNRF 9 – Çregjistrimi i aktiveve financiare, një njësi ekonomike do të çregjistrojë një aktiv financiar,kur, dhe vetëm kur:

(a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar, ose

(b) transferon aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim

Në lidhje me këto aktive financiare, asnjë fluks monetar nuk është marrë deri më 31 dhjetor 2022 dhe nuk priten pagesa as në të ardhmen dhe per keto arsye këto të drejta jane çrregjistruar (fshirë) nga bilanci kontabël.

Tabela në vijim paraqet profilin e rrezikut të llogarisë së arkëtueshme dhe të tjera, bazuar në matricën e provizionit të Shoqërisë.

Duke qenë se eksperienca historike e humbjes për Shoqërinë nuk tregon modele humbjeje të konsiderueshme për segmente të ndryshme të klientëve, provizioni që bazohet në statusin me vonesë nuk bën një dallim midis bazës së ndryshme të klientëve të Shoqërisë për entitetet private.

Në lidhje me gjendjet e OSHEE dhe KESH vlerësimi ka qenë individual.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2022 (përjashtuar OSHEE-në dhe KESH-in)

Përcaktoni humbjen e pritshme	Më pak se 365 ditë me vonesë	Më shumë se 365 ditë me vonesë
Shumat e pa paguara në ditën e raportimit	1,409,246,632	2,839,916
Norma e humbjes së pritshme të kreditit	*8.64%*	*100%*
Provizioni i humbjes së pritshme të kreditit	121,758,909	2,839,916

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2021 (përjashtuar OSHEE-në dhe KESH-in)

Përcaktoni humbjen e pritshme të kreditit	Më pak se 365 ditë me vonesë	Më shumë se 365 ditë me vonesë
Shumat e papaguara në ditën e raportimit	1,872,972,277	1,630,400
Norma e humbjes së pritshme të kreditit	*5.64%*	*100%*
Provizioni i humbjes së pritshme të kreditit	105,635,636	1,630,400

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2022 për OSHEE-në dhe KESH-in

	Monedha	Vlerësimi i Moody's	Faza e klasifikimit	EAD në monedhë vendase	Humbja e prishme(12 muaj) në monedhë vendase
OSHEE	Lek	B2	Faza 1	123,455,688	1,412,763
KESH	Lek	B2	Faza 1	10,678,632,160	122,200,773
TOTALI					**123,613,536**

5. Instrumentet financiarë - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.1 Risku i kreditimit (vazhdim)

- ***Të arkëtueshmet e zhvlerësuara (vazhdim)***

	Monedha	Vlerësimi i Moody's	Faza e klasifikimit	EAD në monedhë vendase	Humbja e prishme(12 muaj) në monedhë vendase
OSHEE	Lek		Faza 2	9,329,229,200	434,086,714
TOTALI					**434,086,714**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2021 për OSHEE-në dhe KESH-in

	Monedha	Vlerësimi i Moody's	Faza e klasifikimit	EAD në monedhë vendase	Humbja e prishme(12 muaj) në monedhë vendase
OSHEE	Lekë	B2	Faza 1	116,253,740	1,351,351
KESH	Lekë	B2	Faza 1	9,054,839,731	105,254,855
TOTALI					**106,606,206**

	Monedha	Vlerësimi i Moody's	Faza e klasifikimit	EAD në monedhë vendase	Humbja e prishme(12 muaj) në monedhë vendase
OSHEE	Lek		Faza 2	9,327,768,309	586,983,923
TOTALI					**586,983,923**

- *Politika e fshirjes*

OST fshin balancat e të arkëtueshmeve (dhe çdo fond lidhur me humbje nga zhvlerësimi) kur drejtimi vendos se të arkëtueshmet janë të pambledhshme. Ky vendim arrihet pasi konsiderohen informacione të tilla si masat domethënëse që janë ndërmarrë për rikuperimin e shumës, dhe se nuk ka mundësi të tjera për mbledhjen e balancave të papaguara.

- *Kolaterali*

Përgjithësisht nuk mbahet kolateral ndaj të arkëtueshmeve dhe më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 nuk është mbajtur ndonjë kolateral i tillë.

5.2.2 Risku i tregut

Risku i tregut është risku nga humbja që rezulton prej ndryshimeve në çmimet e tregut të brendshëm, kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Niveli i riskut të tregut ndaj të cilit ekspozohet Grupi në një moment të caktuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive për çmimet e ardhshme ose ndryshimet në normat e tregut dhe përbërjen e aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave.
Drejtimi cakton limite mbi vlerat e riskut që mund të pranohen, të cilat monitorohen mbi baza mujore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre limiteve në rast të ndryshimeve më të rëndësime të tregut.

- *Risku i kursit të këmbimit*

Risku i kursit të këmbimit rrjedh prej faktit që të ardhurat e shoqerise dhe pjesa më e madhe e të arkëtueshmeve janë të shprehura në LEK, ndërsa pjesa më e madhe e huave të OST janë shprehur në monedhë të huaj (përfshirë EUR, USD, CHF, YEN dhe KRW). Risku është që vlera e flukseve të parasë në monedhë funksionale që lind prej ripagimit të huave dhe interesave respektivë do të ndryshojë si rezultat i lëvizjeve në kurset e këmbimit, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë domethënëse fitimet e shoqerise.

5. Instrumentet financiarë - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.2 Risku i tregut (vazhdim)

- ***Risku i kursit të këmbimit (vazhdim)***

Në lidhje me riskun e kursit të këmbimit, drejtimi vendos limite mbi nivelin e ekspozimit për monedhë dhe në total.

Tabela më poshtë përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare dhe përmbledh ekspozimin e OST ndaj kurseve të këmbimit në datën e raportimit:

	Më 31 dhjetor 2022		
	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
EUR	2,265,994,261	(23,984,464,536)	(21,718,470,275)
USD	1,219,719	(3,127,263,261)	(3,126,043,542)
KRW	-	(2,565,613,391)	(2,565,613,391)
CHF	-	(1,037,216,412)	(1,037,216,412)
YEN	-	(488,425,242)	(488,425,242)
Totali	**2,267,213,980**	**(31,202,982,842)**	**(28,935,768,862)**

	Më 31 dhjetor 2021		
	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
EUR	2,024,650,088	(28,266,976,087)	(26,242,325,999)
USD	1,343,075	(3,028,924,006)	(3,027,580,931)
KRW	-	(2,562,923,620)	(2,562,923,620)
CHF	-	(1,034,441,493)	(1,034,441,493)
YEN	-	(549,166,758)	(549,166,758)
Totali	**2,025,993,163**	**(35,442,431,964)**	**(33,416,438,801)**

Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si vijon:

Në LEK:	2022	2021
EUR	114.23	120.76
USD	107.05	106.54
CHF	116.13	116.82
100 YEN	81.13	92.57

Menaxhimi i riskut të kurseve të këmbimit plotësohet përmes monitorimit të ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqerise ndaj skenarëve të ndryshëm standarde dhe jo standarde të kurseve të këmbimit. Skenarët standardë që konsiderohen në mënyrë të rregullt përfshijnë një rritje ose rënie paralele në kurset e këmbimit prej 100 pikësh bazë (pb).

Një analizë e ndjeshmërisë së shoqerise ndaj një rritjeje ose rënieje në vlerën e lekut përkundrejt monedhave të huaja (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike dhe një pozicion financiar të qëndrueshëm) është si vijon:

	2022		2021	
	100 bp rritje	100 bp ulje	100 bp rritje	100 bp Ulje
Efekti i parashikuar në fitim /(humbje)	(289,357,689)	289,357,689	(334,164,388)	334,164,388

5. Instrumentet financiarë - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.2 Risku i tregut (vazhdim)

- *Risku i normës së interesit*

OST ekspozohet ndaj riskut të normave të interesit sepse vlera e drejtë e huave me normë fikse dhe flukset e parasë të lidhura me huatë me norma të ndryshueshme do të variojnë me ndryshimin e normave të interesit. Shënimi 15 detajon normat e interesit mbi huatë e OST.

Tabela paraqet shumat e agreguara të aktiveve dhe detyrimeve financiare me vlerë kontabël, të kategorizuara sipas afatit më të hershëm midis riçmimit të interesit kontraktual dhe datës së maturitetit.

Në LEK	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Detyrimet me 31 dhjetor 2022				
Llogari të pagueshme e të tjera	18,690,191,579	1,800,000,000	6,987,768,309	27,477,959,888
Kredi dhe hua	(25,102,463,736)	(7,296,816,818)	(9,538,352,073)	(41,937,632,627)
Totali i pagesave të ardhshme	**(6,412,272,157)**	**(5,496,816,818)**	**(2,550,583,764)**	**(14,459,672,739)**
Detyrimet me 31 dhjetor 2021				
Llogari të pagueshme e të tjera	16,163,404,790	1,800,000,000	7,436,307,418	25,399,712,208
Kredi dhe hua	(26,701,954,697)	(6,612,571,975)	(10,660,168,698)	(43,974,695,370)
Totali i pagesave të ardhshme	**(10,538,549,907)**	**(4,812,571,975)**	**(3,223,861,280)**	**(18,574,983,162)**

Menaxhimi i riskut të normës së interesit kundrejt limiteve të hendekut të normës së interesit plotësohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aseteve dhe detyrimeve financiare të shoqerise kundrejt skenarëve standarde dhe jo-standarde të normës së interesit. Skenarët standardë që konsiderohen në bazë të rregullt përfshijnë nje rritje ose ulje paralele prej 100 pikësh bazë në të gjitha kurbat e interesit.

Një analizë e ndjeshmërisë së shoqerise përballë një rritjeje ose nje rënieje në normat e interesit (duke supozuar që nuk do të ketë asnjë lëvizje asimetrike dhe qëndrim konstant te pozicionit financiar) është si më poshtë:

Viti	2022		2021	
	100 bp rritje	100 bp ulje	100 bp rritje	100 bp Ulje
Efekti i parashikuar ne fitim /(humbje)	(144,596,727)	144,596,727	(185,749,832)	185,749,832

- *Risku i çmimeve të tjera*

- ***Çmimi i kapitalit***

OST sh.a nuk ka ekspozim ndaj riskut të çmimit të kapitalit sepse nuk mban aktive financiare që përmbajnë elementë kapitali në datën e raportimit. Nuk është politikë e shoqërisë që të blejë instrumenta të tillë dhe të ekspozohet si rrjedhim ndaj riskut të çmimit të lidhur me lëvizjet në treguesit e tregut të kapitalit.

- ***Tarifat e transmetimit***

Sipas modelit aktual të tregut të energjisë, shoqëria faturon vetëm një tarifë fikse për çdo njësi energjie të transmetuar. Tarifat e transmetimit dhe vlerësimi i kërkesës për energji në tregun lokal janë veçanërisht të rëndësishëm për OST në këto rrethana. Tarifa e transmetimit që OST do të jetë në gjendje të zbatojë janë objekt i miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, duke krijuar në këtë mënyrë risk çmimi.

5. Instrumentet financiarë - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

5.2 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2.3 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. OST është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve që i ka bërë OSHEE Sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë. Drejtimi monitoron çdo muaj parashikimet e flukseve të parasë.

Procesi i adoptuar nga drejtuesit për menaxhimin e likuiditetit përfshin edhe vendosjen e kufizimeve ndaj degëve për shpenzimet në lidhje me aktivitetet e përditshme si shërbimet, furnizimet, investimet, shtyrjen e pagesave ndaj disa kreditorëve, riskedulimin e marrëveshjeve midis palëve dhe parashikimin e pagesave të kredive duke siguruar që këto të jenë të mbuluara.

Tabela e mëposhtme tregon detyrimet më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 sipas maturimit të tyre të kontraktuar. Shumat e paraqitura në tabelën e maturimit janë flukse të kontraktuara të skontuara të parasë.

Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma që paraqitet është përcaktuar duke iu referuar kushteve që kanë ekzistuar në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin ditor të këmbimit në datën e raportimit.

Analiza e maturitetit të detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 është si vijon:

Ne lekë	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Detyrimet me 31 dhjetor 2022				
Llogari të pagueshme e të tjera	(9,959,035,190)	(2,539,270,259)	(877,854,166)	(13,376,159,615)
Kredi dhe hua	(15,143,428,546)	(4,757,546,560)	(8,660,497,907)	(28,561,473,013)
Totali i pagesave të ardhshme	**(25,102,463,736)**	**(7,296,816,819)**	**(9,538,352,073)**	**(41,937,632,628)**
Detyrimet me 31 dhjetor 2021				
Llogari të pagueshme e të tjera	(9,639,059,578)	(1,131,805,276)	(997,854,166)	(11,768,719,020)
Kredi dhe hua	(17,062,895,119)	(5,480,766,699)	(9,662,314,532)	(32,205,976,350)
Totali i pagesave të ardhshme	**(26,701,954,697)**	**(6,612,571,975)**	**(10,660,168,698)**	**(43,974,695,370)**

5.3 Manaxhimi i Kapitalit

Objektivat e shoqerise në manaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e saj për vijimësi të biznesit me qëllim sigurimin e kthimeve për aksionarët dhe të përfitimeve për grupet e tjera të interesit dhe të mbajë një strukturë optimale të kapitalit e cila mundëson reduktimin e kostos së kapitalit.

Njëlloj me shoqëritë e tjera në industri, OST monitoron kapitalin bazuar në raportin e detyrimeve ndaj kapitalit. Ky raport llogaritet si totali i detyrimeve pjesëtuar me kapitalin nën drejtim. Shoqëria konsideron si total kapitali, kapitalin e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar.

	2022	2021
Totali i detyrimeve	44,582,802,309	46,863,954,513
Totali i kapitalit aksionar	32,745,048,489	33,857,658,242
	136%	**139%**

6. Aktive afatgjata materiale

	Toka & Ndertesa	Makineri e Pajisje	Automjete	Pajisje Zyre	Investim ne proces	Total
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**5,480,024,320**	**45,598,967,549**	**404,682,518**	**771,606,301**	**6,201,971,834**	**58,457,252,522**
Sistemime per efektin e kapitalizimit te interesave					37,861	37,861
Shtesa blerje te reja		78,800	2,994,000	9,767,216	2,879,392,759	2,892,232,775
Riklasifikime dhe shtesa te tjera	38,713,581	901,569,236		70,932,913	(994,441,284)	16,774,446
Transferime ne aktive afatgjate jo materiale					(12,881,517)	(12,881,517)
Riklasifikime ne aktive te tjera				(32,230)	(20,155,415)	(20,187,645)
Nxjerrje jashte perdorimit	(2,628,000)				(732,573)	(3,360,573)
Kalime nga (në) magazina (riklasifikime)					(8,387,408)	(8,387,408)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**5,516,109,901**	**46,500,615,585**	**407,676,518**	**852,274,200**	**8,044,804,257**	**61,321,480,461**
Sistemime per efektin e testit te zhvleresimit	(568,032,940)	(4,696,518,809)	(35,491,679)	(87,298,206)	(167,138,084)	(5,554,479,718)
Sistemime per efektin e kapitalizimit te interesave					991,622	991,622
Shtesa blerje te reja	600,000	5,114,014		16,555,000	2,678,844,595	2,701,113,609
Riklasifikime dhe shtesa te tjera	22,748,206	1,625,109,964		28,762,843	(1,532,912,920)	143,708,093
Transferime ne aktive afatgjate jo materiale					(28,965,843)	(28,965,843)
Riklasifikime ne aktive te tjera				(3,719)	(1,415,539,031)	(1,415,542,750)
Nxjerrje jashte perdorimit	(450,819)	(86,548,242)	(65,000)	(1,941,333)	(3,224,608)	(92,230,002)
Kalime nga (në) magazina (riklasifikime)					(15,691,775)	(15,691,775)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	**4,970,974,348**	**43,347,772,512**	**372,119,839**	**808,348,785**	**7,561,168,213**	**57,060,383,697**
Amortizimi i Akumuluar						
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**(157,893,734)**	**(4,262,333,327)**	**(95,657,898)**	**(199,790,904)**		**(4,715,675,863)**
Sistemime per efektin e kapitalizimit te interesave te vitit		(28,678,921)				(28,678,921)
Amortizimi i vitit	(79,320,347)	(1,962,637,214)	(43,992,049)	(117,551,904)		(2,203,501,514)
Pakesime te tjera	1,971,001			13,813		1,984,814
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**(235,243,080)**	**(6,253,649,462)**	**(139,649,947)**	**(317,328,995)**		**(6,945,871,484)**
Sistemime per efektin e testit te zhvleresimit	36,094,102	810,299,040	14,185,816	50,700,552		911,279,510
Sistemime per efektin e kapitalizimit te interesave te vitit		(28,678,921)				(28,678,921)
Amortizimi i vitit	(79,163,041)	(1,838,527,843)	(43,642,674)	(128,337,110)		(2,089,670,668)
Nxjerrje jashte perdorimit dhe te tjera	22,041	21,053,588	40,000	208,165		21,323,794
Gjendja më 31 dhjetor 2022	**(278,289,978)**	**(7,289,503,598)**	**(169,066,805)**	**(394,757,388)**		**(8,131,617,769)**
		-				
Vlera neto më 31 dhjetor 2021	**5,280,866,821**	**40,246,966,123**	**268,026,571**	**534,945,205**	**8,044,804,257**	**54,375,608,977**
Vlera neto më 31 dhjetor 2022	**4,692,684,370**	**36,058,268,914**	**203,053,034**	**413,591,397**	**7,561,168,213**	**48,928,765,928**

6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 OST nuk i ka regjistruar të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Shoqëria është në proces të përgatitjes së një liste të detajuar përmbledhëse mbi pasuritë e paluajtshme për t'u regjistruar.

Nuk ka aktive të lëna si kolateral më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimin e aktiveve të transmetimit, duke përfshirë kryesisht linja transmetimi dhe nënstacione.

Njohja e aktiveve afatgjata materiale behet me vlerën e drejte ne menyre periodike cdo 5 vjet.

- **Matja e vlerës së drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë**

Vlera e drejtë e aktiveve afatgjata materiale u përcaktua nga një grup ekspertësh të jashtëm të caktuar me Vendim të Asamblesë së Aksionarit nr. 121 date 11/10/2018 "Për rivlerësimin e aseteve të shoqërisë OST sh.a". Grupi i ekspertëve përbëhet nga vlerësues të çertifikuar të pasurive të paluajtshme dhe auditues ligjorë.

Raporti i tyre eshte miratuar me vendimin e Asamblesë së aksionarit nr.120 date 10/12/2019 "Për miratimin e raportit të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë OST sh.a" dhe data efektive e rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale të OST është 1 janar 2019.

- **Niveli 3 i vlerës së drejtë**

Vlerat e drejta të aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë kategorizohen në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë. Të dhënat e rëndësishme dhe supozimet zhvillohen me bashkëpunimin e ngushtë të drejtimit.

Vlere e Drejte percaktohet si: "Çmimi më i mundshëm, në datën e specifikuar, në para, ose në termat ekuivalente të parasë, ose në terma të tjerë të përcaktuar në mënyrë ekzakte, për të cilat të drejtat e specifikuara të aktiveve do të shiteshin pas një ekspozimi të arsyeshëm në një treg konkurues, nën të gjitha kushtet e kërkuara për një shitje të drejtë, me blerës dhe shitës të cilët veprojnë me maturi, dije dhe sipas interesit vetjak, dhe duke supozuar që askush nuk vepron nën detyrim". Metodologjitë dhe rregullimet e aplikuara për vlerësimin e aktiveve afatgjata të OST sh.a. i referohen datës së vlerësimit 1 janar 2019 e cila është edhe data efektive e rivlerësimit.

Rivlerësimi i aktiveve te shoqërisë "OST" sh.a. është bërë duke u bazuar në këto metoda:

- Metoda e Tregut ose Metoda e Krahasimit të drejtëpërdrejtë
- Kosto e Zëvendësimit e Amortizuar

Metoda e Tregut ose Metoda Krahasimit të drejtpërdrejtë bazohet në evidenca të krahasueshme me aktive të ngjashme, si dhe në kërkimet e përgjithshme të tregut lokal. Metodologjia konsiston në një analizë të shitjeve dhe ofertave të tjera të pronave të ngjashme pranë pronave në fjalë ose dhe më larg tyre.

Metoda e Kostos apo Metoda e Zevendesimit të Kostos së Amortizuar është përdorur në mungesë të të dhënave (evidencave) të tregut për shitjen e aktiveve.

Metoda e kostos mat vlerën duke vlerësuar Koston e Re të Zevendësimit ose Koston e re të Riprodhimit të pronës dhe pastaj duke përcaktuar zbritjet për amortizimin, i cili duhet të reflektojë moshën, kushtet dhe gjendjen e aktivit gjatë së shkuarës dhe jetëgjatësinë ekonomike të ardhshme të propozuar.

6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Më poshtë jepet informacioni për metodologjinë e vlerësimit që është adoptuar për secilën klasë aktivi:

1) Toka – Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë
2) Ndërtesa – Metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar
3) Makineri dhe Pajisje (ndërtime dhe instalime) – Metoda e kostos se zëvendësimit të amortizuar
4) Nënstacionet – Metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar
5) Linjat e Transmetimit të Energjisë – Metoda e kostos së zëvendesimit të amortizuar
6) Mjetet e Transportit – Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë
7) Paisje të zyrave dhe Paisje Informatike – Metoda e tregut

Inputet kryesore te perdorur per nivelin 3 te hierarkise se vleres se drejte jane vleresuar keto si me poshte:

A. Jetegjatesia e aktiveve bazuar ne llojin e perdorimit te tyre, cilesia, dhe gjendja e tyre faktike;
B. Informacioni I tregut mbi vlerden e shitjes se pronave te ngjashme.

Testi i zhvleresimit

Gjate vitit 2022 në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Aksionarit nr. 99 datë 15/09/2022 "Për rivlerësimin e aseteve të shoqërisë OST sh.a", më datë 08.11.2022, OST sh.a. ka lidhur kontratën me objekt "Për rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale të OST sh.a sipas Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe konkretisht SNK 16 "Aktivet afatgjata materiale" dhe SNK 36 "Zhvlerësimi i Aktive" me grupin e Ekspertëve Vlerësues dhe Audituesëve Ligjorë të përcaktuar me vendimin e lartpërmendur efekti i te cilit do te perfshihet ne pasqyrat financiare me date 01.01.2023.

Ne zbatim te kesaj kontrate, Grupi i eksperteve, pas nje analize te detajuar ka kryer testin e zhvleresimit te aktiveve fikse me 31 dhjetor 2022.

Qëllimi i testit të zhvlerësimit është të sigurojë që Aktivet në pronësi të Shoqërisë, janë regjistruar në pasqyrat financiare në një shumë që nuk tejkalon vlerën e tyre të rikuperueshme.

Ndër metodat e vlerësimit të biznesit grupi i ekspertëve ka zgjedhur Metodën e Aktualizimit të Flukseve të Parasë (Discount Cash Flow) si më të përshtatshme për situaten dhe kushtet ku Shoqëria operon.

Testi i zhvleresimit per aktivet afatgjata materiale është bërë duke u bazuar në Flukset Monetare që krijohen nga këto aktive.

Vlera e rikuperueshme e aktiveve është:

- Vlera e drejtë minus koston e shitjes
- Vlera në përdorim

Duke marrë në konsiderate se Shoqëria nuk ka konkurentë të ngjashem në treg si shumë e rikuperueshme e aktiveve afatgjata është marrë vlera në përdorim.

Për qëllimet e testit të zhvlerësimit, drejtimi i ka trajtuar të gjitha aktivet në një njësi gjeneruese të parasë (NJGJP). Shuma e rikuperueshme është bazuar në vlerën në përdorim, të përcaktuar nga skontimi i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare që do të gjenerohen nga përdorimi i vazhdueshëm i NJGJP -së.

6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e vlerës në përdorim janë paraqitur më poshtë:

Faktori i skontimit	10.03%
Norma e rritjes terminale	3%
Noma e kapitalizimit	7.03%

Parashikimet e flukseve të parasë përfshijnë vlerësime specifike për pesë vjet dhe një normë të rritjes në përjetësi pas kësaj. Shkalla e rritjes në përjetësi është përcaktuar në bazë të vlerësimit të drejtimit të rritjes vjetore të përbëre të fitimit para interesave, taksave dhe amortizimit (EBITDA) brenda kapaciteteve normale të prodhimit të shoqerise.

Marzhi i EBITDA ka pasur luhatje gjatë periudhës së analizës, pasi ka ndjekur trendin e biznesit, lidhur më së tepërmi me luhatjet në koston e transmetimit.

EBITDA e parashikuar u bazua në supozimet kryesore, të cilat përfaqësojnë vlerësimet e drejtimit si më poshtë:

Energjia totale e transmetuar në rrjetin e OST pritet të rritet gradualisht nga 9.44 TWh në 2022 në 9.85 TWh në 2026.

Tarifa e transmetimit te energjise elektrike eshte parashikuar të lëvizë nga 1.37 ALL/ KWh në 2023 në 1.79 ALL /KWh në 2026.

Të ardhurat pritet të rriten nga 2022 në 2026 kryesisht për shkak të rritjes së tarifës së transmetimit. Pjesën më të madhe të të ardhurave nga transmetimi e përbën energjia e transmetuar ndaj OSHEE rreth 70% të totalit.

Gjithahtu, shpenzimet operative pritet të rriten përgjatë viteve, duke reflektuar kështu normën e mundshme të inflacionit.

Shpenzimet për blerjen e energjisë për të mbuluar humbjet në rrjet pritet të përbejnë pjesën më të konsiderueshme, prej 38% totalit të shpenzimeve operative, kjo si pasojë e rritjes së konsiderueshme të cmimit të energjisë.

Vlerat e përcaktuara për supozimet kryesore paraqesin vlerësimin e drejtimit për trendin e ardhshëm në sektorin e energjisë elektrike dhe janë bazuar në të dhënat historike dhe zhvillimet e ardhshme nga burimet e jashtme dhe të brendshme.

Ne perfundim sipas metodologjisë e perdorur dhe llogaritjeve përkatëse, Vlera e Rikuperueshme (Vlera në Përdorim) e Aktiveve Fikse të OST që rezulton më 31/12/2022, është më e ulët se Vlera Kontabël, duke rezultuar kështu në zhvlerësim prej 4,650 milione leke.

Me shkresën nr. 3898/1 prot. datë 28/03/2023, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është vendosur përfshirja e efekteve të Testit të Zhvlerësimit të Aktiveve Afatgjata Materiale të OST sh.a. në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

7. Aktive afatgjata jomateriale

	Programe Komjuterike
Vlera Bruto	
Gjendja më 1 janar 2021	**713,702,638**
Shtesa blerje te reja	1,360,000
Shtesa nga investimet	12,881,516
Nxjerrje jashtë përdorimit	(16,276)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**727,927,878**
Sistemime për efektin e testit të zhvlerësimit	(28,810,472)
Shtesa blerje te reja	31,438,000
Shtesa nga investimet	28,965,843
Gjendja më 31 dhjetor 2022	**759,521,249**
Amortizimi i Akumuluar	
Gjendja më 1 janar 2021	**(310,885,039)**
Amortizimi i vitit	(163,401,218)
Nxjerrje jashtë përdorimit	16,270
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**(474,269,987)**
Sistemime për efektin e testit të zhvlerësimit	22,315,256
Amortizimi i vitit	(129,117,441)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	**(581,072,172)**
Vlera neto më 31 dhjetor 2021	**253,657,891**
Vlera neto më 31 dhjetor 2022	**178,449,077**

8. Aktive me të drejtë përdorimi

	Ndertesa	Mjete transporti	Total
Gjendja më 01 janar 2022			
Shtesa	7,429,070	29,115,621	36,544,691
Pakesime			
Gjendja më 31 dhjetor 2022	**7,429,070**	**29,115,621**	**36,544,691**
Amortizimi i Akumuluar			
Gjendja më 01 janar 2022			
Amortizimi i vitit	(2,682,720)	(5,823,124)	(8,505,844)
Pakesime			
Gjendja më 31 dhjetor 2022	**(2,682,720)**	**(5,823,124)**	**(8,505,844)**
Vlera neto më 31 dhjetor 2022	**4,746,350**	**23,292,497**	**28,038,847**

OST sh.a. ka lidhur kontratë qiraje me "EL" sh.p.k. me qëllim dhënien me qira të një ndërtese për të shërbyer si magazinë. Afati i qirasë është 36 muaj dhe pagesa mujore e qirasë është 220,000 lekë (amenduar më 26 prill 2022).

OST sh.a. ka lidhur kontratë qiraje me OE "ASG" sh.p.k. lidhur me automjetet e dhëna me qira. Kontrata ka afat maturimi 5 vjet, me këste mujore 579 000 lekë për një shumë totale 34 740 001 lekë.

8. Aktive me të drejtë përdorimi (vazhdim)

Për të llogaritur aktivet me të drejtë përdorimi, është llogaritur vlera aktuale të pagesave të qirasë sipas afateve të tyre të maturimit dhe kushteve të kontratës. Shpenzimet e interesit janë llogaritur duke marrë në konsideratë normën e interesit sipas publikimit më të fundit nga Banka e Shqipërisë mbi normat mesatare të peshuara të interesit për kreditë e reja nga institucionet jofinanciare. Shpenzimet e zhvlerësimit janë llogaritur me metodën lineare gjatë jetës së qirasë.

Detyrimet e qirasë me 31 dhjetor 2022 paraqiten si me poshtë:

	31 dhjetor 2022
Pjesa afatshkurtër	3,359,918
Pjesa afatgjatë	26,991,103
	30,351,021

Përveç kësaj, OST sh.a. aplikon përjashtimin e njohjes së qirasë me afat të shkurtër për qiratë afatshkurtra (ato kontrata qiraje që kanë një afat prej 12 muajsh ose më pak nga data e fillimit dhe nuk përmbajnë një opsion blerjeje).

OST sh.a. aplikon gjithashtu përjashtimin mbi njohjen e qirave me vlerë të ulët për qiratë që konsiderohen të jenë me vlerë të ulët. Pagesat e qirasë për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët njihen si shpenzime me metodën lineare gjatë afatit të qirasë.

9. Aktivet financiare

Aktivet financiare përfshijnë investime në aksione dhe kredi të arkëtueshme nga palët si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktive financiare afatgjata		
Entitete të tjera	5,603,600	5,603,600
Hua dhënë punonjësve	5,868,158	7,269,658
Total i aktive finaciare afatgjata	**11,471,758**	**12,873,258**
Aktive financiare afatshkurtra		
Hua për palët e treta	20,000,000	20,000,000
Hua dhënë punonjësve	815,750	230,000
Total i aktive finaciare afatshkurtra	**20,815,750**	**20,230,000**
Total i aktive finaciare	**32,287,508**	**33,103,258**

Entitete të tjera përfshijnë pjesëmarrjen në kapital,të mbajtur me kosto historike, të South East Europe Capacity Allocation Office (SEE CAO) e cila është një shoqëri e vendosur në Mal të Zi dhe e themeluar së bashku me shoqëritë e transmetimit të Malit të Zi, Kroacisë, Greqisë, Kosovës, Bosnje Hercegovinës dhe Turqisë.

Gjithashtu ne entitete te tjera përfshihet pjesëmarrja e OST sha, si aksionare me 57.25% te kapitalit themeltar ne Bursën Shqiptare te Energjisë - Alpex sha. Me Vendimin nr. 12 datë 08.09.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., si dhe me Vendimin nr. 130 datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratuan pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a

Hua për palët e treta lidhet me huanë e dhënë për Albgaz sh.a me vendimin nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. Afati i maturimit të kredisë është dy vite. Sipas marrëveshjes mes OST dhe Albgaz Sh.a. huamarrësi ka për detyre kthimin e shumes se plote te huase me norme interesi 0 (zero) tek huadhënësi brenda dy viteve nga hyrja ne fuqi e kësaj marrëveshje. Me date 22/10/2019 është firmos Amendimi Nr.1 i marrëveshjes se mësipërme sipas te cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumes se plote te huase tek Huadhënësi me norme interesi zero brenda tre viteve nga hyrja ne fuqi e marrëveshjes.

9. Aktive financiare (vazhdim)

Më datë 07/08/2020, është firmos Amendimi Nr.2 i marrëveshjes se mësipërme sipas te cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumes se plote te huase tek Huadhënësi me norme interesi zero brenda katër viteve nga hyrja ne fuqi e marrëveshjes. Me date 28/07/2021 eshte firmos Amendimi Nr. 3 i marreveshjes se mesiperme sipas te cilit Huamarresi ka per detyrim kthimin e shumes se plote te huase tek Huadhenesi me norme interesi zero brenda pese viteve nga hyrja ne fuqi e mareveshjes.

10. Inventarët

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Materiale ndihmëse	222,886,302	241,670,482
Lëndë djegëse	13,861,217	26,394,333
Pjesë ndërrimi	132,503,282	152,867,392
Materiale të tjera	345,386,256	271,701,472
Totali i inventarit	**714,637,057**	**692,633,679**

11. Llogari të arkëtueshme e të tjera

Llogari të arkëtueshme e të tjera analizohen si më poshtë

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Te arketueshme afatgjata		
Klientë për mallra, produkte e shërbime	8,787,768,309	9,236,307,418
	8,787,768,309	**9,236,307,418**
Te arketueshme afatshkurtra		
Klientë për mallra, produkte e shërbime	10,430,304,194	10,640,054,564
Paradhënie për punonjësit	4,458,779	141,610
Shteti – TVSH e zbritshme	296,948,239	11,303,048
Debitorë të tjerë	2,376,640,116	969,240,126
Asete per tu mare nga KESH sha	73,069,514	73,069,514
Minus: provizioni për rënien në vlerë	(794,676,382)	(921,095,715)
	12,386,744,460	**10,772,713,147**
Total	**21,174,512,769**	**20,009,020,565**

Klientë për mallra, produkte e shërbime analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
OSHEE sha	17,639,904,788	17,849,158,019
KESH sha	50,386,175	41,557,729
Shoqeri private	1,527,781,540	1,985,646,234
Total	**19,218,072,503**	**19,876,361,982**

Pjesa me e madhe e të arkëtueshme nga OSHEE sh.a, më 31 dhjetor 2022 dhe 2021, lidhen kryesisht me shuma për shitjet e bëra në vitet paraardhëse.

Me 17 dhjetor 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomise se bashku me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise miratuan "Planin e masave per uljen e detyrimeve te detyrueshme ne sektorin e energjise elektrike"

11. Llogari të arkëtueshme dhe të tjera (vazhdim)

Me 15 prill 2021 ndermjet OSHEE sha dhe OST sha eshte firmosur "Mareveshja per pagesen e detyrimeve te prapambetura" ne shumen 9,687,768,309 leke. Marreveshja perfshin nje skeme pagese duke filluar nga data 1 korrik 2021 per nje shume minimale prej 360 milione leke ne vit ose 6.5% te faturave aktuale vjetore, te cilat do te shlyejne tepricat e mbartura. Bazuar ne kete mareveshje shumat totale te papaguara Nga OSHEE sha kundrejt OST sha do te shlyhen deri ne vititn 2047.

Të arkëtueshmet nga OSHEE përfshinë gjithashtu vlerat 642,184,772 lekë dhe 1,760,983,525 lekë të cilat përfaqësojnë fatura të lëshuara nga OST për sistemimin e faturave të shërbimeve të balancimit për vitet 2016 dhe 2017 sipas vendimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 110 datë 14.05.2018 janë të papranuara nga OSHEE sipas shkresës së OSHEE nr 10615/1 datë 11.06.2018. Në bazë të të njëjtit vendim OST ka njohur të pagueshme ndaj KESH duke pranuar faturat me të njëjtën vlerë të lëshuara prej saj (shënimi 15). OSHEE ka ankimuar vendimin e ERE në Gjykatën Administrative të shkallës së parë e cila me vendim nr. 3851 datë 29.10.2018 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së OSHEE. Vendimi është ankimuar nga OSHEE në gjykatën e apelit dhe çështja është në proces.

OST nga ana e saj i është drejtuar gjykatës për të kërkuar njohjen e detyrimit nga OSHEE dhe shlyerjen e detyrimit me kërkesë padinë nr. 7475 datë 31.10.2018. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim nr. 3809 datë 13.03.2019 vendosi pezullimin e gjykimit me arsyetimin se duke qënë se padia e OST është mbështetur në vendimin e ERE nr 110 datë 14.05.2018, çështja nuk mund të zgjidhet pa u zgjidhur më parë çështja e ngritur nga OSHEE në gjykatën e apelit me vendim të formës së prerë. Përgjatë vitit 2022 nuk ka ndodh asnjë ndryshim në statusin e ceshtjeve pasi pritet vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit.

12. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet për furnitorët kanë të bëjnë me parapagimet për furnitorët e mallrave dhe shërbimeve, kontraktuar për qëllim të ndërtimit të aktiveve të transmetimit.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime për furnitore	1,481,225,255	1,594,946,804
Shpenzime të shtyra	83,762,784	18,053,581
	1,564,988,039	**1,613,000,385**

13. Mjete monetare në arkë e bankë

Mjetet monetare analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Para në bankë	4,701,069,408	3,739,485,835
Garanci Bankare	5,102,165	5,102,165
Total	**4,706,171,573**	**3,744,588,000**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të cilat klasifikohen si aktive financiare të matura me koston e amortizuar, kanë qenë subjekt i matjes së provizionit "Qasjes së përgjithshme". Megjithatë, për shkak se llogaritë rrjedhëse janë në kërkesë, humbjet e pritshme 12-mujore dhe përgjatë gjithë jetës janë të njëjta. Kjo do të thotë se humbjet e pritshme kanë qenë jomateriale.

13. Mjete monetare ne arkë dhe bankë (vazhdim)

Rreziku i kredisë në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre është i kufizuar duke qenë se janë depozituar në banka me vlerësime të larta të përcaktuara nga agjencitë ndërkombëtare e kreditit.

31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021	Monedha	Vlerësimi i Moody's
American Bank of Investment ("ABI")	Lek	A1
National Commerce Bank ("BKT")	Lek	Ba2
Credins Bank	Lek	B1
Intesa SanPaolo	Lek	Baa3
Raiffeisen Bank Albania	Lek	A2
Tirana Bank	Lek	B2
Union Bank	Lek	B2
OTP Bank	Lek	Baa3

14. Kapitali

- *Kapitali aksionar*

Numri total i aksioneve të zakonshme më 31 dhjetor 2022 ishte 25,055,608 aksione (2021: 22,146,576 aksione) me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Të gjitha aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara.

Gjatë vitit 2021 ka pasur rritje kapitali në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 21 dt. 24.03.2021 "Për zmadhimin e kapitalit të OST sha" si rezultat i përfshirjes në kapital të detyrimit (Dividend) i llogaritur dhe i pa likuiduar për vitet 2011-2016.

Regjistrimi ne QKB i rritjes se kapitalit është kryer ne datën 12/04/2021

Gjate vitit 2022 ka pasur rritje kapitali bazuar ne shkresën nr.18565/2 dt. 06.01.2022 vendim i Asamblesë se Përgjithshme të Aksionarit nr. 24 date 06/01/2022 "Mbi Pasqyrat Financiare të shoqërisë OST sha për vitin 2020", me ane te se ciles eshte caktuar eksperti për hartimin e raportit për rritjen e kapitalit nëpërmjet përfshirjes se fitimit të pashpërndarë ne kapitalin e OST sha.

Regjistrimi ne QKB i rritjes së kapitalit është kryer në datën 30/05/2022.

Gjithashtu gjate vitit 2022 ka pasur rritje kapitali bazuar ne shkresën nr. 14247/1 dt. 04.08.2022 vendim i Asamblesë se Përgjithshme të Aksionarit nr. 83 date 04/08/2022 "Mbi Pasqyrat Financiare të shoqërisë OST sha për vitin 2021", me ane te se ciles eshte caktuar eksperti për hartimin e raportit për rritjen e kapitalit nëpërmjet përfshirjes se fitimit të pashpërndarë dhe grupit te rezervave te tjera (pervec rezerves ligjore dhe rezerves se rivleresimit), ne kapitalin e OST sha.

Regjistrimi ne QKB i rritjes së kapitalit është kryer në datën 23/11/2022.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2020
Gjendje më 1 janar	22,146,576,634	21,335,542,634
Rritje e kapitalit	2,909,031,366	811,034,000
Gjendje më 31 dhjetor	**25,055,608,000**	**22,146,576,634**

- *Rezerva të rivleresimit*

Rezervat e rivlerësimit në shumën ALL 5,421,483,544 lekë (2021: 7,858,369,995 leke) përfaqësojnë diferencën pozitive të rivlerësimit që vjen nga vlerësimi i pavarur i aktiveve afatgjata materiale dhe huave afatgjata me vlerën e drejtë në momentin fillestar dhe mbajtjen e tyre më pas me kosto të amortizuar.

14. Kapitali (vazhdim)

- *Rezerva ligjore*

Rezervat ligjore përfaqësojnë ndarjen e një pjese të fitimeve të pashpërndara në përputhje me ligjin nr. 9901 "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare" të datës 14 prill 2008, i cili kërkon që të paktën 5% e fitimit, por jo më shumë se 10% e kapitalit mbahet si rezervë ligjore.

- *Rezerva të tjera*

	Nr. i vendimit	Data e vendimit	Total
Balanca me 31 dhjetor 2020			**230**
Rritje	21	24/03/2021	209
Rritje	18565/2	31/12/2021	517,708,244
Zvogelim		31/12/2021	(81,156)
Balanca me 31 dhjetor 2021			**517,627,527**
Zvogëlim	52	04/05/2022	(454)
Rritje	83	04/08/2022	627,594,442
Zvogëlim	103	24/10/2022	(1,131,162,785)
Zvogelim		31/12/2022	(190,222)
Balanca me 31 dhjetor 2022			**13,868,508**

Rezervat e tjera janë krijuar nga mbajtja e fitimeve të mbartura. Gjatë vitit 2021 në bazë shkresës së Asamblese se Pergjithshme te Aksionarit nr. 18565/2 prot datë 06/01/2022, rezervat e tjera janë rritur me 517,708,244 lekë nga shpërndarja e rezultatit financiar të vitit 2020.

Gjatë vitit 2022 në bazë Vendimit të Asamblese se Pergjithshme te Aksionarit nr 83 date 04/08/2022, rezervat e tjera janë rritur me 627,594,443 lekë nga shpërndarja e rezultatit financiar të vitit 2021.

Gjithashtu gjate vitit 2022 ne baze te vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Aksionarit nr 103 date 24/10/2022, rezervat e tjera jane zvogëluar me 1,131,162,785 leke si rezultat i perfshirjes se tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

- *Interesat e pakicës*

Interesat e pakices me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Kapitali pakicës	106,875,000	106,875,000
Rezerva te tjera	(202,646)	(60,602)
Humbje e mbartur	(13,937,127)	(673,858)
Humbje e vitit financiar	(22,237,162)	(13,263,269)
Total	**70,498,065**	**92,877,271**

Interesat e pakices perfaqesojne pjesëmarrjen e KOSTT, si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 42.75% të kapitalit themeltar.

15. Huatë

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Hua Afatgjata		
Ministria e financave dhe ekonomisë	10,835,480,061	12,230,800,257
Marreveshje nën-huaje me KESH	2,582,564,406	2,912,280,975
Totali i huasë afatgjatë	**13,418,044,467**	**15,143,081,232**
Hua Afatshkurtra		
Ministria e financave dhe ekonomisë	8,188,669,041	10,137,047,639
Marreveshje nën-huaje me KESH	6,954,759,505	6,925,847,480
Totali i huasë afatshkurter	**15,143,428,546**	**17,062,895,119**
Ministria e financave dhe ekonomisë	19,024,149,102	22,367,847,895
Marreveshje nën-huaje me KESH	9,537,323,911	9,838,128,455
Total Detyrime per hua	**28,561,473,013**	**32,205,976,350**

15. Huatë (vazhdim)

Huatë kanë afate maturimi që variojnë nga një në pesëdhjetë vite dhe janë të garantuara nga Qeveria Shqiptare. Vlerat kontraktuale mesatare të interesit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 ishin si më poshtë:

	EUR	USD	CHF	KRW	YEN	ALL
2022	1.92%	1.24%	0.00%	2.50%	2.45%	0.75%
2021	2.05%	1.78%	0.00%	2.50%	2.45%	0.75%

Vlerat kontabël të huave të Shoqërisë që janë të shprehura në monedhat e mëposhtme:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
EUR	21,415,028,402	23,927,557,160
USD	2,878,575,595	2,832,345,691
CHF	1,037,216,412	1,034,441,493
JPY	488,425,242	549,166,758
KRW	2,565,613,391	2,562,923,620
ALL	176,613,971	1,299,541,628
	28,561,473,013	**32,205,976,350**

Në momentin e ndarjes, KESH i ka nën-huazuar Shoqerisë (OST) disa hua nga institucione të ndryshme. Pas ndarjes së dy shoqërive, ndarja e huave midis OST dhe KESH u bazua në përqindjen e vlerësuar më 30 qershor 2006 dhe kjo përqindje u përdor për të transferuar pagesat e principalit dhe interesit tek OST.

Pavaresisht se OST nuk ka shlyer të gjitha detyrimet për huatë afatgjata, Ministria e Financave dhe Ekonomisë duke marrë në konsideratë që OST sh.a. vazhdon të shlyejë detyrimet e saj kundrejt kreditoreve të huaj si dhe faktin që kryen herë pas here pagesa ndaj MFE per kredite e nënhuazuara edhe për vitin 2023 konfirmon se do te vijohet me kërkesen për pagesë sipas skedulit të Marreveshjeve përkatëse.

16. Llogari te pagueshme tregtare dhe të tjera

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrimet afatgjata		
Furnitore për aktivet afatgjata materiale	1,939,270,259	531,805,276
Furnitore për mallra dhe shërbime	1,477,854,166	1,597,854,166
Total	**3,417,124,425**	**2,129,659,442**
Detyrimet afatshkurtra		
Furnitore për aktive afatgjata materiale	136,987,842	406,113,389
Furnitore për mallra dhe shërbime	8,725,083,886	7,276,761,713
Furnitore për fatura të pambërritura	525,072,973	1,441,291,483
Kreditore te tjere	498,351,668	449,826,635
Detyrime tatimore	73,538,821	65,066,357
Totali	**9,959,035,190**	**9,639,059,577**
Totali	**13,376,159,615**	**11,768,719,019**

Llogaritë e pagueshme tregtare afatshkurtra për aktivet afatgjata materiale lidhen kryesisht me punimet dhe materialet e furnizuara, por të pagueshme në vitin pasardhës.

Llogaritë e pagueshme afatgjata për aktivet afatgjata materiale lidhen me garancitë e performancës të pagueshme me mbarimin e kontratës së furnizimit.

Furnitore per mallra dhe sherbime afatgjata perfaqesojne detyrimin afatgjate te “Mareveshjes per pagesen e detyrimeve te prapambetura” te firmosur ndermjet OSHEE sha dhe OST sha. Marreveshja perfshin nje skeme pagese duke filluar nga data 1 korrik 2021 per nje shume minimale prej 360 milione leke ne vit ose 6.5% te faturave aktuale vjetore, te cilat do te shlyejne tepricat e mbartura.

16. Llogari te pagueshme tregtare dhe te tjera (vazhdim)

Bazuar ne kete mareveshje shumat totale te papaguara Nga OSHEE sha kundrejt OST sha do te shlyhen deri ne vititn 2047.

Gjithashtu ne llogarine furnitore për mallra dhe shërbime jane perfshire fatura të lëshuara nga KESH për sistemimin e faturave të shërbimeve të balancimit për vitet 2016 dhe 2017 në vlerat 642,184,772 lekë dhe 1,760,983,525 lekë, sipas vendimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 110 datë 14.05.2018.

Furnitorë për faturat e pambërritura përbëhet nga fatura të cilat janë lëshuar pas datës 31 dhjetor 2021 por që i korrespondojnë detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2022.

17. Grante

Grantet analizohen si me poshtë;

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Grante të tjera nga KESH sh a	6,480,939	6,815,995
Grante nga OSHEE sh.a	257,423,811	288,839,123
Grante të tjera për Linjë paraburgimi Fier	7,172,963	7,339,104
Grante të tjera për Linjë paraburgimi Elbasan	7,558,874	7,917,248
Grant shtylla 6/1 për linjën 110 KV "Elbasan – Metalurgji"	1,304,285	1,376,965
Grante për pjesët rezervë "Devoll Hydropower" Elbasan	24,146,587	24,146,587
Grante Linja e tensionit të larte Hec Peshqesh	41,616,349	43,372,806
Grante nga KfW Linja 400KV Tiranë Podgorice	310,407,718	318,136,993
Grante nga KfW Linja 400KV Tiranë Prishtinë	45,237,617	46,406,392
Grante nga KfW Linja Shqipëria e jugut	79,828,846	81,867,192
Grante kontejnerë nga firma C&G D.O.O	3,325,853	3,325,853
Grant – KfW dhe EU për Linjën 400 kV Shqipëri - Maqedoni	359,808,116	326,531,061
Grant- Flexitranstore & Farcross	9,457,670	9,108,643
Grant CWI Transformator 110/10 kV 5MVA-Metalurgji 2	1,806,228	
Totali	**1,155,575,856**	**1,165,183,962**

Grantet lidhen me kostot dhe aktivet, dhe përfshijnë grante direkt nga qeveria ose nga donatorë për qeverinë shqiptare lidhur me aktivitetet e Shoqërisë dhe për të financuar aktivet.

Levizjet në grante paraqiten si me poshtë;

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendja më 1 janar	1,165,183,962	956,002,240
Amortizimi i granteve gjate vitit	(62,931,913)	(107,297,679)
Grante te marra gjate vitit	53,323,807	316,479,401
Gjendja më 31 dhjetor	**1,155,575,856**	**1,165,183,962**

18. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyre njihet me diferencat e përkohshme ne mes të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe të shumave të përdorura për qëllime tatimi.

Tatimi i shtyrë llogaritet bazuar në normën tatimore të miratuar prej 15% (2021: 15%).

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrime të shtyra tatimore	781,655,599	1,419,824,652

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Më 1 janar	1,419,824,652	1,441,109,600
Regjistruar në të ardhurat gjithëpërfshirëse		
Përfshirë ne rezultatin neto	(638,169,053)	(21,284,948)
Më 31 dhjetor	**781,655,599**	**1,419,824,652**

18. Tatimi i shtyre mbi fitimin (vazhdim)

Lëvizjet në detyrimet e shtyra tatimore gjatë vitit janë si vijon:

	Aktive Afatgjata Materiale	Total
Me 01 janar 2021	**1,441,109,600**	**1,441,109,600**
Regjistruar në të ardhurat gjithëpërfshirëse		
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(21,284,948)	(21,284,948)
Me 31 dhjetor 2021	**1,419,824,652**	**1,419,824,652**
Regjistruar në të ardhurat gjithëpërfshirëse		
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(638,169,053)	(638,169,053)
Me 31 dhjetor 2022	**781,655,599**	**781,655,599**

19. Parapagimet nga kliente

Parapagimet nga kliente analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
SEE CAO	260,796,227	104,488,846
Totali	**260,796,227**	**104,488,846**

Parapagimet nga klientë përfaqësojnë shërbime të faturuara në avance ndaj shoqërisë SEE CAO për rezervim të drejtash transmetimi për muajin janar 2023 dhe të arkëtuara ne dhjetor 2022.

20. Të ardhura të shtyra

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
SEE CAO	87,472,993	68,597,443
Totali	**87,472,993**	**68,597,443**

Të ardhura të shtyra përfaqesojne shërbime të faturuara në avance ndaj shoqerisë SEE CAO për rezervim të drejtash transmetimi për muajin janar 2022.

21. Te ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	5,874,029,428	5,747,210,621
Të ardhura nga alokimet e kapaciteteve	1,829,594,040	1,151,131,569
Të ardhura nga disbalancat e energjisë	2,992,902,683	1,864,557,643
Të ardhura nga transmetimi ndërkufitar	8,256,706	12,702,418
Të ardhura nga transmetimi i të dhënave	39,084,894	14,916,372
Të ardhura nga grantet	62,931,913	107,297,679
Të tjera	56,235,477	24,587,835
Totali	**10,863,035,141**	**8,922,404,137**

22. Shpenzime për materiale

Shpenzime për materiale analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Materiale konsumi	71,929,497	46,923,612
Lendë djegëse	42,720,001	39,638,645
Të tjera	2,096,680	1,763,891
Totali	**116,746,178**	**88,326,148**

23. Kosto transmetimi

Kosto transmetimi analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Shpenzime të transmetimit ndërkufitar	230,801,768	309,034,855
Humbje teknike gjate transmetimit	3,115,544,964	2,088,566,003
Sherbimet ndihmëse – KESH	534,923,836	439,408,639
Totali	**3,881,270,568**	**2,837,009,497**

OST i mban kostot që krijohen në formën e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit në kuadrin e modelit të tregut të energjisë që aplikohet nga viti 2008 e në vazhdim. Me vendim të ERE humbjet teknike gjatë transmetimit do të mbulohen nga OST përmes sigurimit të energjisë me çmimin e tregut përmes ankandeve të organizuara nga OST.

Me VKM Nr. 456, datë 29.06.2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", duke filluar nga Muaji Korrik 2022, eshte percaktuar sigurimi i humbjeve të energjisë elektrike në transmetim nga ana e KESH sh.a. me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, çmim i cili për vitin 2022 sipas Vendimit të ERE Nr. 253, datë 21.12.2021 është 8.5652 lekë/kWh.

24. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Qira	10,728,139	3,572,072
Mirëmbajtje dhe riparime	153,024,603	121,748,084
Sigurime	14,789,295	12,728,592
Kërkime, trajnime dhe studime	44,589,396	164,003,496
Personel jashtë njësisë	175,757,930	117,040,015
Shpenzime per patenta, licensa	18,522,725	13,307,995
Publicitet, reklama	264,993	806,484
Transferime, udhëtime, dieta	22,610,144	30,665,743
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	12,454,944	12,989,602
Shpenzime për shërbimet bankare	1,784,374	1,943,645
Taksa dhe tarifa vendore	5,094,068	1,200,133
Taksa e regjistrimit	1,700,618	2,166,804
Tatime të tjera	37,662	72,031
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	1,406,086	548,696
Gjoba dhe dëmshpërblime	229,776,167	195,625,902
Nxjerrje aktivesh jashtë përdorimit	118,153,737	1,389,573
Tarifa antaresimi	98,816,973	74,838,856
Kosto e materialeve te shitura dhe te tjera	21,853,796	60,649,201
Totali	**931,365,649**	**815,296,924**

24. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit (vazhdim)

Shpenzime për personel jashtë njësisë përfaqësojnë shpenzime të kryera për auditimin ligjor për certifikimin e pasqyrave financiare te konsoliduara, shërbime vlerësimi, rritje kapitali si dhe shërbimi për ruajtjen fizike të aktiveve të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Vlerësim i aseteve dhe detyrimeve	1,900,000	1,950,000
Auditim i pasqyrave financiare nga audites ligjore caktuar nga MFE	5,750,000	4,950,000
Auditim I pasqyrave financiare nga shoqëri e pavarur audituese	1,250,000	1,250,000
Rritje kapitali e shoqërisë	3,620,000	1,605,000
Këshilli Mbikëqyrës	4,360,639	4,328,880
Shërbim konsulence dhe auditim për kontrollet e sigurisë	1,450,000	744,800
Vleresim i aktiveve afatgjata materiale	20,790,000	
Vleresim i materialeve te nxjerra jashte perdorimi	9,219,000	
Anetare te komisionit te posacem te shpronesimeve, akt ekspertime	250,000	
Roje private	127,168,291	102,211,335
Total	**175,757,930**	**117,040,015**

Vlerësimi i aseteve dhe detyrimeve është kryer për të dy vitet nga shoqëria Deloitte Albania procedurë e tenderuar nga OST sh.a në bazë të kërkesave të Bankës Botërore dhe donatorëve të huaj.

Auditimi ligjor i pasqyrave financiare të vitit 2021 (shpenzim i vitit 2022) është kryer nga zj. Anita Pulaj, zj. Vullnetare Hoxha, shoqëria Thinksmart-Business Consulting & Auditing, shoqëria Euro-Audit Consultancy sh.p.k, si dhe nga Studio L.E.A.L Auditing shpk, përkatësisht me tarifën 1,150,000 lekë (pa tvsh) secili.

Auditimi i pasqyrave financiare nga një shoqëri e pavarur audituese (kusht i vendosur në marrëveshjet e huave afatgjata lidhur me Bankën Botërore dhe donatorë të huaj) për të dy vitet është kryer nga shoqëria Grant Thornton sh.p.k procedurë e tenderuar nga OST.

Për zmadhimin e kapitalit të OST sha gjatë vitit 2021, si rezultat i përfshirjes në kapital të detyrimit (Dividend) i llogaritur dhe i pa likuiduar për vitet 2011-2016 është caktuar nga MFE zj. Aida Maloku.

Zmadhimet e kapitalit gjate vitit 2022 si rezultat i perfshirjes ne kapital te fitimeve te pashperndara dhe rezervave te tjera jane kryer nga zj. Vullnetare Hoxha dhe zj, Fatime Alliu perkatesisht me tarifat 1,770,000 leke (pa tvsh) dhe 1,850,000 leke (pa tvsh).

Vleresimi i aktiveve afatgjata materiale gjate vitit 2022, është kryer nga grupi i ekspertëve të jashtëm të caktuar me Vendim të Asamblesë së Aksionarit nr. 99 date 15/09/2022 "Për rivlerësimin e aseteve të shoqërisë OST sh.a". Grupi i ekspertëve përbëhet nga zj. Vullnetare Cela (Hoxha) dhe Studio Load shpk si vlerësues të çertifikuar të pasurive të paluajtshme; si dhe zj. Fatime Alliu, zj. Engjellushe Rami, zj. Mimoza Cara, z. Egin Kocollari dhe z. Ilia Cece si audites ligjorë.

Lidhur me kete sherbim i cili perfundon me 30/06/2023, gjate vitit 2022 eshte paguar pagesa paraprake ne formen e paradhenies ne masen 30% te vleres se kontrates, perkatesisht 2,970,000 leke (pa tvsh) secili.

Gjithashtu gjate vitit 2022 jane kryer kater procedura vleresimi per asete dhe materiale te dala jashte perdorimit perkatesisht dy nga Studio Load shpk me tarifat 2,313,000 leke (pa tvsh) dhe 4,596,000 leke (pa tvsh), rivleresim skrapi nga zj. Vullnetare Cela (Hoxha) me tarifen 855,000 leke (pa tvsh) dhe nga z. Klajdi Pulaj me tarifen 1,455,000 leke (pa tvsh).

25. Shpenzime personeli

Shpenzime personeli analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Pagat dhe shpërblimet e personelit	831,711,646	830,368,255
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	161,348,095	158,627,821
Kompesime shpenzimesh për personelin	262,937,944	275,585,218
Totali	**1,255,997,685**	**1,264,581,294**

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2022 ishte 790 (31 dhjetor 2021: 789)

26. Provigjione/fshirje të llogarive

Provizionet për llogaritë e arkëtueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Provigjon i llogarive te arketueshme	123,298,001	(572,101,523)
Totali	**123,298,001**	**(572,101,523)**

27. Të ardhura dhe shpenzime financiare neto

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Shpenzime për interesa	(447,486,322)	(487,494,972)
Shpenzime financiare	(54,500,000)	-
Fitime neto nga kursi i këmbimit në aktivitetet financiare	1,380,081,432	452,829,573
Te ardhura nga interesat, kredite dhe depozitat	769,247	7,214,891
Totali	**878,864,357**	**(27,450,508)**

Shpenzimet financiare të njohura nga Grupi gjatë viteve 2022 dhe 2021 lidhen me interesat për huatë. Shpenzimet e interesit lidhen me kostot për aktivet që janë gati për përdorimin e tyre të synuar.

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

OST e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Në vitin 2022 norma e tatimit mbi fitimin ishte 15% e të ardhurës së tatueshme (2020: 15%).

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Tatimi mbi fitimin e periudhës	580,009,613	282,715,808
Tatimi i shtyrë mbi fitimin (Shënimi 17)	(638,169,053)	(21,284,948)
Totali	**(58,159,440)**	**261,430,860**

Në vijim jepet një rakordim i tatimit mbi fitimin i përllogaritur në bazë të normës së tatimit të aplikueshme ndaj shpenzimit të tatim fitimit:

	Norma	31 dhjetor 2022	Norma	31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit		**827,191,172**		**922,056,590**
Tatimi i përllogaritur me normën	15.0%	131,881,189	15.0%	142,962,267
Tatimi i përllogaritur për shpenzime të pazbritshme	51.0%	448,128,424	14.7%	139,753,540
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	**66.0%**	**580,009,613**	**29.7%**	**282,715,807**

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse taksa dhe interesa të tjera mund të jenë të detyrueshme.

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

Drejtimi beson se përllogaritjet e tij të detyrimeve tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet e hapura fiskale bazuar në vlerësimin prej tij të shumë faktorëve, përfshirë interpretimin e ligjit mbi tatimet dhe eksperiencat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në çmuarje dhe supozime dhe mund të përfshijnë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme.

Shoqëria mund të ndryshojë gjykim nën dritën e informacionit të ri që mundësohet, në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese. Këto ndryshime ndaj detyrimeve tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor gjatë periudhës në të cilën ky përcaktim bëhet.

29. Palët e lidhura

OST kontrollohet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë ("MFE") e Republikës së Shqipërisë, e cila zotëron 100% të aksioneve të saj. Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet me palet e lidhura paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
(a) Shitje mallrash dhe shërbimesh		
Shitje mallrash:		
OSHEE sh.a	7,343,555,124	6,420,497,380
KESH sh.a	400,308,876	690,874,918
	7,743,864,000	**7,111,372,298**
(b) Blerje mallrash dhe sherbimesh		
OSHEE sh.a	240,388,348	363,238,736
KESH sh.a	4,187,482,584	3,649,008,429
	4,427,870,932	**4,012,247,165**
(c) Shpërblimi i drejtuesve kryesorë		
Paga dhe shpërblime të tjera afat-shkurtra për punonjësit	56,247,885	58,351,556
Këshilli Mbikëqyrës	4,360,639	4,328,880
	60,608,524	**62,680,436**
(d) Balancat e fund-vitit me palet e lidhura		
Llogari të arkëtueshme nga palët të lidhura:		
Autoritetet fiskale (TVSH)	296,948,239	11,303,048
OSHEE sh.a	17,639,904,788	17,883,646,100
KESH sh.a	50,386,174	43,184,204
	17,987,239,201	**17,938,133,352**
(e)Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë		
KESH sh.a	9,021,606,377	6,598,749,644
OSHEE sh.a	841,098,123	1,321,823,295
Autoritetet fiskale (tatim mbi te ardhurat personale)	11,088,231	10,290,485
Autoritetet fiskale (sigurime shoqërore)	23,115,761	22,789,954
Autoritetet fiskale (tatim ne burim)	1,025,576	744,614
Autoritetet fiskale (tatim fitimi)	329,317,985	131,164,240
	10,227,252,053	**8,085,562,232**
(f) Kredi dhe hua dhene palëve të lidhura		
ALBGAZ	20,000,000	20,000,000
	20,000,000	**20,000,000**
(g) Kredi dhe hua nga palë të lidhura		
KESH sh.a	9,537,323,911	9,838,128,454
Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Shqipërisë	19,024,149,102	22,367,847,896
	28,561,473,013	**32,205,976,350**

Huatë e marra nga OST sha janë garantuar nga Qeveria e Shqipërisë.

30. Detyrime të mundshme

Në rrjedhën normale të biznesit, shoqëria ka hasur në kërkesa ligjore dhe gjyqësore; Drejtimi konsideron se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet e tjera të mbetura deri më 31 dhjetor 2022. Bazuar në kontratën nr. 1008 datë 02.02.2018 "Marrëveshja për trajtimin e të drejtave dhe detyrimeve të OST Security Sha" ndërmjet Shoqërisë OST sh.a dhe OST Security, OST ka detyrime të kushtëzuara lidhur me pretendimet për proceset e vazhdueshme ligjore kundër OST Security Sh.a në shumën 22,902,500 lekë (2021: 24,002,500 lekë).

Më 31 dhjetor 2022, OST kishte angazhime në shumën 4,274,769 mijë lekë (2021: 4,277,488 mijë lekë) lidhur me projektet për ndërtimin e aseteve për transmetimin e energjisë.

31. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të cilat do të kërkonin korigjim të pasqyrave financiare të ndodhura midis datës së raportimit 31 dhjetor 2022 dhe datës së autorizimit të këtyre pasqyrave financiare.